

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7737 E enjte 13 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dekalogu i një studenti

Nga ATJON ZHITI




Një kryengritje morale

Dekalogu i një studenti” u krijua me mendime, përsiatje dhe porosi të studentit të filozofisë, Atjon V. Zhiti, të nxjerra nga shkrimet në librin e tij “Për atë ...
Vijon në faqen 20

Opinion Ditës

Nga ELSA SKËNDERI



Dialogu i dajakut verbal

Dje në mbremje kryeministri u rrek të shiste si dialog me puls e pathos një shfaqje të pakëndshme me një dorë të rinjsh të partisë së tij, të cilëve herë ...
Vijon në faqen 21



Akuzë për Edmond Tupjen dhe Robert Aliajin

Studentët, sot para parlamentit. Policia procedon profesorët: Prishët rendin publik

Rama: Ejani, bëjmë pakt për universitetin. Kryemadhi: Ja zgjidhja jonë për 8 kërkesat

TIRANË. Pas protestës të së martës, ku studentët bllokuan disa rrugë të kryeqytetit, policia e Tiranës ka proceduar penalisht 25 persona. Mes personave që po ndiqen penalisht në gjendje të lirë janë dhe pedagogu Edmond Tupe si dhe artisti i njohur Robert Aliaj. Ndërkaq, mes atyre që do të ndiqen penalisht janë studentë dhe studentët ...
Në faqet 2-3

PROJEKTIGJI/ PENSION SUPLEMENTAR PER MINATORET, NAFTETARET DHE METALURGET

RRITJE PENSIONESH DERI NE 20% PER 26 MIJE VETA

Ministria e Financave përgatit draftin, nga 0.6 deri në 1% shtesë për çdo vit pune në 3 profesionet. Ndarja sipas kategorive, përfitojnë edhe invalidët.



(Në foto) Minatore në protestë (foto ilustruese)

PROTESTA

Banorët e Unazës së Re bllokojnë rrugën: Të rrezohet projekti i Ramës

Në faqen 6

VENDIMI I GJYKATES

Dënimi i Shullazit, ambasada amerikane: Të festojme edhe për vetë procesin

Në faqen 7

KENGA

Festivali në RTSH, lista e këngëtarëve që synojnë trofeun, zbardhen surprizat

Në faqen 12

HISTORIA

Fate të trishta, inxhinierët e Maliqit dhe historia e Harry Fultzit

Në faqen 16

SHPERBLIMI I FESTAVE



5 mijë lekë për çdo pensionist, qeveria: Paratë, brenda dhjetorit

Në faqen 8

Ngrihet Këshilli i Prokurorisë: I hapet rruga zgjedhjes së kryeprokurorit të përhershëm

SHBA: Antikorrupsioni, gati BKH dhe SPAK-u

Ambasada përshëndet votimin: U ndryshua historia e Shqipërisë

TIRANË - Një ditë pas kompletimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është krijuar Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ditën e djeshme u zgjodhën 6 anëtarët e KLGJ-së, ndërsa në votim morën pjesë 360 gjyqtarë. Ashtu si në KLP, edhe tje në garë ishin 10 gjyqtarë, të cilët sfiduan



njëri-tjetrin për 6 vende në këtë institucion. Nga gjykatat e shkallëve të para janë zgjedhur Dritan Hallunaj, gjyqtar i Krimeve të Rënda; Blunilda Kadi, gjyqtare e Tiranës dhe automatikisht Marçela Shehu, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ...
Në faqen 7

PROTESTA E STUDENTEVE PROCEDIMI

Reagon profesori: Më 'zhvirgjeruan' dëshminë e penaltetit, duan të më bëjnë hero me zor

Protesta, procedohen penalisht pedagogu Edmond Tupe, Robert Aliaj dhe 23 të tjerë

Bllokuan rrugët, mes të proceduarve studentë dhe aktivistë të forumeve rinore të partive politike

TIRANË

Pas protestës të së mar-tës, ku studentët bllokuan disa rrugë të kryeqytetit, policia e Tiranës ka proceduar penalisht 25 persona. Mes personave që po ndiqen penalisht në gjendje të lirë janë dhe pedagogu Edmond Tupe si dhe artisti i njohur Robert Aliaj. Ndërkaq, mes atyre që do të ndiqen penalisht janë studentë dhe studentët organizatorë, si edhe aktivistë të forumeve rinore të partive politike. "Më datë 11.12.2018 u referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, për shtetasit: Edmond Tupe, Robert Aliaj, Altin Goxhaj, Mirela Ruko, Klodian Leka, Estela Nazarko, Xhuljano Bregasi, Henri Fero, Liri Guci, Gentian Doci, Malbor Duka, Nehbi Bushaj, Klajdi Bello, Redi Muci, Luan Myrtaj, Erdi Bërçulli, Agron Pepaj, Migen Qiraxhi, Bledar Hysa, Adriatik Lapaj. Dhe aktivistët politike Gaetano Doci dhe Andrea Gjini (LSI) dhe Kristina Tonal (FRPD). Ata akuzohen se dje në orën 09:00, tek sheshi "Nënë Tereza", në rrugën "Muhamed Gjollështa", e më pas në rrugën e "Durrësit", përpara Ministrisë së Arsimit kanë protestuar në mënyrë të paligjshme, pa lejen e organeve kompetente duke prishur rendin e qetësinë publike, penguar qarkullimin e mjeteve të transportit, duke hedhur sende të forta në oborrin e institucionit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkohë, policia deklaroi se po punon për identifikimin e personave të tjerë që kanë bllokuar rrugën të sheshi "Rilindja", pasi janë të fotografuar.

Por, procedimi penal nga policia nuk e ka frenuar aspak pedagogun Edmond Tupja për të mbështetur protestën e studentëve para godinës së Kryeministrisë. Disa orë pas njoftimit të policisë, ky i fundit është shtafur në krah të studentëve duke mbështetur kauzën e tyre. Që në nisje të protestës, Tupja iu është bashkuar zërave të protestuesve para Ministrisë së Arsimit dhe ka kërkuar që kërkesat e tyre të plotësohen nga organet përkatëse. Profesori reagoi, duke u shprehur se po ia tund themelet qeverisë dhe kryeqeveritarit. Ai pohoi se ka qenë në protestë së bashku me Robert Aliajin dhe qindra të tjerë, por ai nuk është organiza-



Pedagogu Edmond Tupe në protestën e studentëve

PERSONAT E PROCEDUAR PENALISHT

- | | |
|---------------------|----------------------------|
| 1. Edmond Tupe | 14. Redi Muci |
| 2. Robert Aliaj | 15. Luan Myrtaj |
| 3. Altin Goxhaj | 16. Erdi Bërçulli |
| 4. Mirela Ruko | 17. Agron Pepaj |
| 5. Klodian Leka | 18. Migen Qiraxhi |
| 6. Estela Nazarko | 19. Bledar Hysa |
| 7. Xhuljano Bregasi | 20. Adriatik Lapaj |
| 8. Henri Fero | 21. Nerid Shehu |
| 9. Liri Guci | 22. Bislim Lakna |
| 10. Gentian Doci | 23. Gaetano Doci (LSI) |
| 11. Malbor Duka | 24. Andrea Gjini (LSI) |
| 12. Nehbi Bushaj | 25. Kristina Tonalj (FRPD) |
| 13. Klajdi Bello | |

tor i kësaj proteste. Ndërsa, theksoi se me këtë vendim po kërkojnë ta bëjnë hero me zor.

REAGIMI I EDMOND TUPES

Profesori Edmond Tupja dje e ka gjetur veten për herë të parë në "listën e zezë" të policisë. Në një intervistë për mediat, profesor Tupja tha se në adresën e tij nuk ka ardhur asnjë njoftim për procedim penal, por se këtë

e ka mësuar nga një miku i tij. Sa i përket procedimit penal, ai saktësoi se as ai dhe as familja e tij nuk kanë shkelur asnjehere ndonjë ligj, duke ironizuar se ky procedim penal "ka zhvirgjeruar dëshminë e tij të penaltetit". "Nuk kam asnjë njoftim zyrtar që jam proceduar penalisht. Ma tha një miku im. Deri dje kam pasur dëshmi penalteti të virgjër. Jam rritur në një familje me

DEKLARATA

"Nuk kam asnjë njoftim zyrtar që jam proceduar penalisht. Deri dje kam pasur dëshmi penalteti të virgjër. Jam rritur në një familje me edukatë dhe në respekt të ligjit. Nga 4 akuzat, nuk e gjej veten tek asnjëra. Unë isha mbështetës, jo organizator. Nuk kam hedhur vezë apo shishe ndaj institucionit, nuk kam bllokuar rrugën, sepse kam qëndruar në trotuar...", deklaroi profesori. Gjithashtu, ai u shpreh se po ia tund themelet qeverisë dhe kryeqeveritarit. "Do të më fusë në burg? Po do të më bëjë hero. Ai do me zor të më bëjë hero mua. Unë s'dua të bëhem hero".

edukatë dhe në respekt të ligjit. Nga 4 akuzat, nuk e gjej veten tek asnjëra. Unë isha mbështetës, jo organizator. Nuk kam hedhur vezë apo shishe ndaj institucionit, nuk kam bllokuar rrugën sepse kam qëndruar në trotuar...", deklaroi profesori. Gjithashtu, ai u shpreh se po ia tund themelet qeverisë dhe kryeqeveritarit. "Do të më fusë në burg? Po do të më bëjë hero. Ai do me zor të më bëjë hero mua. Unë s'dua të bëhem hero. Ai do të më bëjë hero. Kryemjeshtri i kësaj gjendjeje. Edhe prapa hekurave të burgut, prapë do t'i mbështes. Për mua është një turp i madh, jo se jam unë personi i proceduar, por djo procedim pa arsye thjesht se vjen me urdhër nga lart, nga një mendje e çuditërisht e sfazuar, unë s'e kuptoj. Ky është skandal. Më kujtohet koha e Pinoçetit në Kili, ka mbetur vetëm të na vijnë nëpër shtëpi dhe të na vrasin. Të na e bëjnë si në kohën e Enver Hoxhës", tha Tupja.



Protesta e studentëve

POLICIA E SHTETIT

Policia e Shtetit ka deklaruar se procedimet penale ndaj disa protestuesve janë bërë në bazë të ligjit për ata persona që e kanë cenuar atë. Në një njoftim për mediat, nisur edhe nga reagimet e shumta pas procedimeve penale për artistin Robert Aliaj, pedagogun Edmond Tupe si dhe protestues të tjerë, policia ka sqaruar se këta persona e kanë cenuar qartazi ligjin, kryesisht në formën e bllokimit të akseve rrugore të vendit, goditjes me sende të forta, apo djegies së materialeve të dëmshme për shëndetin e qytetarëve në mjedise të rëndësishme publike.



Procedimi penal, Robert Aliaj: Duan të destabilizojnë çështjen e studentëve

TIRANË - Pas nisjes së procedimit penal në gjendje të lirë, ka reaguuar edhe këngëtari Robert Aliaj. Në një prononim ekskluziv për "BalkanWeb", ai tha se procedimi ndaj tij është absurd, pasi nuk ka marrë pjesë dje (të martën) në protestë dhe ka qenë në palestër në orën 10:00. Procedimi sipas tij bëhet për të njoollur emrin e tij dhe për të destabilizuar çështjen e studentëve. "Ata që e kanë bërë këtë duan të më vënë kundër shtetit. Është absurde, sepse unë kam qenë në fitnes deri në orën 10:00 dhe më pas në shtëpi. Kjo bëhet për të destabilizuar çështjen e studentëve dhe unë jam kundër politizimit të lëvizjes studentore. Unë jam student dhe kam bërë thirrje që ata të tregojnë dialog dhe vendosmëri. Me dialog nënkuptoj paqe. Unë nuk kam qenë fare në qendër dje. Duan të më njoollin emrin. Unë nuk mbështes asnjë forcë politike", deklaroi Robert Aliaj.




"Jemi kundër kësaj diktature shumë të madhe, na kanë hedhur për vite si lecka"

Protesta para Kryeministrisë, studentët nuk tërhiqen

Të rinjtë mbledhen sot para parlamentit

Valentina Madani

Në ditën e tetë të protestës, studentët e universiteteve publike kanë bojkotuar mësimin dhe kanë marshuar nga fakultetet e tyre drejt Ministrisë së Arsimit dhe Kryeministrisë. Me pankarta në duar, ata kanë zgjedhur të ndahen në dy grupe për të mos hequr dorë deri në plotësimin e kërkesave të tyre. Nën thirrjet "Ulni tarifat", "Kafshatë që s'kapërdihet është or vlla tarifa", "Shkurtoni kostot, jo ëndrrat", "Koha për studentët", "Duam barazi", "Nëse s'ka drejtësi për studentët, s'ka paqe për qeverinë" etj., të rinjtë edhe pse më të paktë në numër se ditët e mëparshme, kanë theksuar se nuk do të ulen të dialogojnë me kryeministrin e vendit dhe nuk do të negociojnë pa nisur zbatimin e kërkesave të tyre. Ata kanë bërë thirrje që nesër (sot) protesta e tyre do të zhvendoset para parlamentit, ndërkohë që kanë theksuar se të gjithë bashkë nuk do të tërhiqen. Protestës së studentëve para Kryeministrisë i janë bashkuar edhe një grup studentësh të ardhur nga Shkoderja. Edhe mbrëmjen e djeshme, studentët kanë zgjedhur të qëndrojnë pa lëvizur para godinës së Kryeministrisë dhe Ministrisë së Arsimit e kanë përballuar të ftohtin mbështjellë me batanije e madje kanë ndezur edhe një zjarr për t'u ngrohur sadopak. Të rinjtë kanë bërë thirrje që të bashkohen të gjithë në kauzën studentore në një kohë që qytetarët u kanë shpërndarë ushqim e batanije në shenjë sensibilizimi. "Kjo protestë është kundër një diktature shumë të madhe, sepse ne nuk dëgjohejmë e madje nëse dikur të persekutojmë, sot asnjë student nuk është dëgjuar, por jemi hedhur poshtë si lecka me disa fasada të turpshme. Mesazhi im nuk është për pushtetarët, por për studentët, për miqtë e mi që ndihen të demotivuar. Ne duhet të vazhdojmë!", - tha studentja.



Studentët duke protestuar gjatë natës para Kryeministrisë

8

DITA E PROTESTËS

Në ditën e tetë të protestës, studentët e universiteteve publike kanë bojkotuar mësimin dhe kanë marshuar nga fakultetet e tyre drejt Ministrisë së Arsimit dhe Kryeministrisë. Me pankarta në duar, ata kanë zgjedhur të ndahen në dy grupe për të mos hequr dorë deri në plotësimin e kërkesave të tyre.



Qeveria miraton vendimin për rikonstruksionin e konvikteve

Qeveria ka miratuar vendimin për rikonstruksionin e konvikteve, duke plotësuar kështu një prej kërkesave të studentëve. Bëhet fjalë për një marrëveshje mes qeverisë shqiptare dhe asaj gjermane. VKM-ja përcakton qartë se projekti për rikonstruksion të konvikteve kap një vlerë prej 3 milionë eurosh. "Këshilli i Ministrave vendosi miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efiçencës së energjisë, faza III, me një grant në shumën 2 927 765.96 (dy milionë e nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) euro, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë", - theksohet në vendimin e miratuar ditën e djeshme nga Këshilli i Ministrave.



Studentët: Kërkojmë një Shqipëri si e gjithë Europa

Studentët kanë kërkuar edhe ndërtimin e një Shqipërie si e gjithë Europa. Kauzës së tyre i janë bashkuar edhe mjaft qytetarë të grupmoshave të ndryshme, ndërsa studentët kërkojnë me ngulim plotësimin e kërkesave që kanë. "Asnjë media nuk ka sabotuar, asnjë media nuk na ka dezinformuar, falë këtyre kemi sensibilizuar të gjithë qytetarët për të kaluar natën këtu. Mos flisni për gjëra që i kemi provuar në kurriuzin tonë. Po fituam këtë kauzë, do fitojmë edhe shumë të tjera. Ne nuk jemi më me Shqipërinë, e duam si gjithë Europa, por do e bëjmë ne së bashku Shqipërinë si gjithë Europa. Ky është një shembull i të rinjve europianë, po mbajmë një protestë të qetë", tha një student. "Secili mund të jetë është i lirë, e rëndësishme është që kur kapet ky mikrofon, të mos orientohejmë nga pikat që kemi. Ne nuk kemi politikë. Sikat ynë kanë qenë 8 pikat dhe një kauzë. Shoh që të gjithë po kërcënohen, ne mbrëmë nuk e patëm të lehtë, duam të fitojmë kauzën, pastaj me gjërat e tjera", - tha një tjetër student.

KUNDËR DIKTATURËS

"Kjo protestë është kundër një diktature shumë të madhe, sepse ne nuk dëgjohejmë e madje, nëse dikur të persekutojmë, sot asnjë student nuk është dëgjuar, por jemi hedhur poshtë si lecka me disa fasada të turpshme. Mesazhi im nuk është për pushtetarët, por për studentët, për miqtë e mi që ndihen të demotivuar. Ne duhet të vazhdojmë!", - tha studentja.



DEKLARATA E SENATIT TË UT-SË

Edhe senati akademik i Universitetit të Tiranës ka dalë në mbështetje të protestës së studentëve dhe ka theksuar në një deklaratë se nuk ka bërë kërkesë drejt MASR për vendosje tarifash për provimet e mbartura. "Universiteti i Tiranës nuk ka bërë asnjë kërkesë për vendosje tarifash për provimet e mbartura (pika 4 e shfuqizuar e Vendimit nr.288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave. Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për stu-

SFIDË TË FTOHTIT

Edhe mbrëmjen e djeshme studentët kanë zgjedhur të qëndrojnë pa lëvizur para godinës së Kryeministrisë dhe Ministrisë së Arsimit. Ata e kanë përballuar të ftohtin të mbështjellë me batanije e madje kanë ndezur edhe një zjarr për t'u ngrohur sadopak. Qytetarët u kanë shpërndarë ushqim e batanije në shenjë sensibilizimi.



THIRRJET

Nën thirrjet "Ulni tarifat", "Kafshatë që s'kapërdihet është or vlla tarifa", "Shkurtoni kostot, jo ëndrrat", "Koha për studentët", "Duam barazi", "Nëse s'ka drejtësi për studentin, s'ka paqe për qeverinë" etj., të rinjtë edhe pse më të paktë në numër se ditët e mëparshme, kanë theksuar se nuk do të ulen të dialogojnë me kryeministrin e vendit.



dent që ndjekin studimet në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë)", - thekson senati i UT-së. Më tej, ky i fundit shton se mbështet kërkesën e studentëve për përgjysmimin e tarifave të shkollimit dhe madje ka ngarkuar Bordin e Administrimit të bëjë përlogaritjen e efekteve financiare për UT-në. "Në kuadër të arsimit cilësor, etikës në kërkim, transparencës dhe përfshirjes më të gjerë të studentëve, merr për-

sipër të përshpejtojë të gjitha mekanizmat përkatëse materiale dhe procedurale për realizimin e tyre brenda këtij viti akademik. Në aktet e brendshme të Universitetit të Tiranës do të parashikohen rregulla të qarta për rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në veprimtaritë akademike dhe financiare. Universiteti i Tiranës merr përsipër ngritjen e një grupi të përbashkët pune pedagogo-studentë për shqyrtimin e të gjitha problematikave të ngjitura si dhe të çështjeve të tjera që lidhen me përmirësimin e veprimtarisë së UT-së", - thekson senati.

PROTESTA ZGJIDHJA

LSI: Shpenzimet buxhetore për arsimin universitar, 14 miliardë e 909 milionë lekë

Amendamentet, Monika Kryemadhi: Zgjidhja për 8 kërkesat e studentëve

Deputetët e LSI kthehen në Kuvend

Valentina Madani

LSI ofron zgjidhje për studentët përmes dy amendamenteve, njëri që 1% e Prodhimit të Brendshëm Bruto të shkojë për Arsimin dhe tjetri, për krijimin e një Fondi Emergjence që do të shërbente për investimet në infrastrukturën arsimore. Dy deputetët e LSI, Floida Kërpaçi dhe Kejdi Mehmetaj, u rikthyen dhe në Kryesinë e Kuvendit, ku dorëzuan dy amendamentet e LSI-së për plotësimin e kërkesave të studentëve. Mehmetaj u shpreh se votat e LSI janë për studentët. Më herët ishte kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi që paraqiti dy propozime për amendimin e ligjit për buxhetin e vitit 2019, që do të reflektojnë sipas saj përbushjen e kërkesave minimale të studentëve, protesta e të cilëve ka hyrë tashmë në javën e dytë. Ajo kërkoi votimin me urgjencë të dy amendamenteve. Kryemadhi sulmoi qeverinë, duke thënë se për të përbushur kërkesat minimale të studentëve, -pikën 1, 4, 5, 6, 7 dhe 8, -duhet të marrin vetëm 1 për qind të shumës prej 46% që qeveria ua jep koncesionarëve, duke zgjidhur kështu hallet e studentëve që reflektojnë varfërinë e familjeve shqiptare. "I bëjmë thirrje Kuvendit t'i kalojë me urgjencë në seancën e nesërme, pasi është e vetmja mënyrë të shlyejmë mëkatin e politikës, për të dalë nga ky ngërc i tmerrshëm, që të hapet rruga për krijimin e një strategjie afatgjatë", tha ajo. Kryemadhi i bëri thirrje Ramës të votojë me 140 vota në Kuvend për të zgjidhur situatën. "Koha e tij ka mbaruar, propaganda e tij mbaroi, tallja që shqiptarët i bëjnë sot Ramës në rrjetet sociale është më e madhe se tërheqja zvarrë e bustit të Enver Hoxhës, ulu dhe zgjidh situatën, nuk ka LSI-st, komunist e ballist që nuk është sot me studentët", tha zj.Kryemadhi. Sipas saj, dy amendamentet e LSI për ligjin e buxhetin e vitit 2019 zgjidh kërkesat numër 1, 4, 5, 6 dhe 7 të para-



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

THIRRJA

"I bëj thirrje Edi Ramës të miratojmë urgjentisht me 140 vota në parlament këto dy amendamente, të cilat shterojnë përfundimisht kërkesat minimale të studentëve. Sepse kjo është e vetmja mënyrë për t'i rikthyer studentët në bankat e shkollës", -deklaro zj. Kryemadhi.

Procedimet për protestën e studentëve

Basha: Hetohesh kur ngrihesh ndaj qeverisë, jo kur vjedh 30 mln euro

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, akuzoi dje se paratë e projekteve fasadë që pasurojnë Edi Ramën dhe klientët e tij të investohen në arsim. Në një postim në Twitter, Basha shprehet se vetëm 30 milionë euro që Edi Rama tenton të vjedhë me kompanitë gashë mjaftojnë për të ndërtuar një kampus modern për Universitetin e Tiranës, të cilin e studentët e kërkojnë prej vitesh. "Ky shtet po degradon përditë në një regjim hajdut dhe shtypës në duar të kriminit, por që do të shembet përpara vullnetit të njerëzve. Kapen duke vjedhur dhe pas-truar 30 milionë euro, por as hajduti psiqik dhe asnjë



Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

nga vartësit e tij nuk është duke u hetuar penalisht. Ngrritën zërin kundër qeverisë, të drejtë të cilën ja u ka dhënë

Zoti dhe Kushtetuta dhe ka filluar procedim penal për 25 qytetarë të lirë"-shprehet Basha.

qitura nga studentët. Amendamenti i ligjit për arsimin zgjidh kërkesat e studentëve 2 dhe 3.

PROPOZIMET
LSI propozon që totali i shpenzimeve buxhetore për arsimin universitar të bëhet nga 7 miliardë e 500 milionë lekë të kthehet në 14 miliardë

909 milionë dhe 916 mijë lekë shqiptare. Sipas Kryemadhit, vetëm 1% e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Sot buxheti që ka miratuar qeveria shqiptare për 2019, 46% të PBB e kalon për të paguar koncesionarët e saj. Studentët kërkojnë vetëm 1%. LSI shprehet se totali i shpen-

zime buxhetore për fondet e shkencës të bëhet 620 milionë lekë të reja të bëhet 1 miliard e 240 milionë lekë të reja. Këto i gjen shumë kollaj. Kurse në nënin 15 të shtohet nëni 16 me përmbajtje: Të krijohet Fondi i Emergjencës për arsimin me vlerë 5 miliard lekë nga Ministria e Financave dhe



Protesta e banorëve të "Astirit"



Protesta, Vasili: Rama kërkon të mashtrtojë studentët

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili reagoi dje lidhur me protestën e studentëve duke akuzuar Kryeministrin Rama se kërkon të mashtrtojë studentët me të ashtuquajturin dialog. Vasili u shpreh se LSI ka depozituar amendamentet në Kuvend që i japin zgjidhje çështjes së studentëve. "I gjithë opinioni publik sot është i shqetësuar për Universitetin dhe arsimin e lartë. Përballë studentëve është një kryeministër mashtrues që propozon të ashtuquajturin dialog. Zgjidhja e vetme është vetëm një marrja e përgjegjësisë me ligj. LSI ka dorëzuar amendamentet në Kuvend që i japin zgjidhje çështjes së studentëve. Me këto amendamente rritet buxheti për arsimin. Protesta e studentëve është plotësisht e drejtë", tha Vasili.



Nishani: Shqiptarët kanë detyrim të shkojnë te shqiptarët

Ish-presidenti, Bujar Nishani theksoi se sot shqiptarët kanë vetëm një detyrim dhe përgjegjësi. Sipas tij kryeministri i dështuar as nuk i mposht dot studentët, as i përçan dot e as e shuan shpirtin e revoltës kundër sistemit më të korruptuar, më të pa aftë dhe më shpellar që ngrihet dhe tentoi t'ua sheshti studentëve dhe shqiptarëve. "Kjo vetëm dhe vetëm për një fakt të thjeshtë. Studentët sot përfaqësojnë 99% të shqiptarëve, kryeministri i dështuar vetëm 1% të tyre. Kush kërkon ta vërtetojë këtë fakt të thjeshtë le të dalë e takojë shqiptarët sot në çdo rrugë, dyqan, kafene e kudo ku mund t'i ndesh ata. Shqiptarët sot kanë një detyrim dhe përgjegjësi. Nëse nuk besojnë tek politika, të shkojnë tek studentët", shprehet z. Nishani.

deri dhënë një kompanie fiktive offshore të Edi Ramës në SHBA, 30 milionë euro janë 5 miliardë lekë që ai ua vodhi shqiptarëve në një muaj t'i hedhë automatikisht menjëherë në rikonstruksionin e godinave dhe konvikteve të studentëve", -tha z.Monika Kryemadhi.

Ekonomisë, të cilat do të përdoren për përmirësimin e infrastrukturës të shoqërive të trajtimit të studentëve në Tiranë dhe rrethe dhe infrastrukturës universitare në përgjithësi. "Paratë do t'i gjejë me anulimin e tenderit të Unazës së Re dhe me kthimin mbrapsht të parave të një ten-



"Kështu funksionon në klinikën e doktoreshë Monës dhe në gjumin e Lul Artistit"

Rama: Një ditë tjetër e humbur kot, pakt për universitetin

Qeveria ka mohuar shkarkimin e anëtarëve të bordeve

Një tjetër ditë të humbur kot. Kështu e ka përkufizuar dhe në mbremje kreu i qeverisë, Edi Rama, protestën e studentëve dhe vendosmërinë e tyre për të mos dialoguar me qeverinë, duke kërkuar plotësim të 8 kërkesave të tyre pa kushte. Një koment në rrjetet sociale dhe pasditë, kryeministri Rama shprehet se është e paarsyeshme për një demokraci që të parashtröh kërkesa, por pa qenë gati që të ulet dhe të diskutosh për to. "Një tjetër ditë e humbur me arsyen e mosarjes: Kam kërkesa, po s'dua të flas për to, prandaj m'i plotëso!", shkroi Rama. Më tej ai aludon se studentët po përdoren nga politika dhe në mënyrë të veçantë nga opozita dhe grupime të tjera pranë saj. "Kështu funksionon në klinikën e doktoreshë Monës, në gjumin e Lul Artistit, në megafonin e profesor Qorrit, po jo në mësimet e demokracisë e të prindërve tuaj. Unë ju pres", u shpreh Rama në komentin e vet. Ndërkohë që më parë, gjatë paraditës së djeshme ai pati disa komente të tjera në rrjetet sociale, duke kërkuar t'u tregojë studentëve se vijon të mbetet i gatshëm që të dialogojë me ta në çdo kohë dhe për çdo gjë që ata shtrojnë. Rama u kujtoi studentëve që vijonin të protestonin para zyrës së tij dhe para Ministrisë së Arsimit se gjithçka duhet bërë tani është të ulet dhe të flasin. Në mesazhin e tij, ai theksoi se 8 kërkesat e studentëve janë vetëm pikënisja e një faze të re transformimi të botës sonë universitare. "Të dashur studentë të protestues, gjithçka na duhet tani është të ulet dhe të flasin. 8 pikat janë për mua vetëm pikënisja e një faze të re transformimi të botës sonë universitare. Dhe këtë transformim mund, duhet e do ta bëjmë vetëm së bashku, përmes një Pakti për Universitetin mes studentëve dhe qeverisë", shkroi Rama. Ai u shpreh i gatshëm që një

nga kërkesat kryesore të studentëve që ka të bëjë me uljen e tarifave ta plotëson të para festave të fundvitit. "Adresimin e 8 pikave duhet të nisim pa humbur kohë. Kemi punë për të bërë dhe nëse doni që ulet e tarifave, ta mbyllim para pushimeve tuaja të Vitit të Ri, s'ka

realisht minuta për të humbur me llogjet e kazanëve dhe rrugët shkencore të doktoreshë Monës e të profesor Lulit. Unë jam gati dhe s'kam asnjë kusht, prandaj bëhuni mbarë e më çoni fjalë, kur e ku doni të takohemi. Përgafime dhe kurajë, sepse do ju duhet shumë kur ta

kuptoni që kjo që keni nisur është ku e ku më dhe, sesa ato 8 pika", theksoi më tej kryeministri në mesazhin e tij. Ndërkohë që gjatë ditës së djeshme Kryeministria hodhi poshtë një lajm të hapur në media se kryeministri Rama kishte urdhëruar ndërkohë shkarkimin e përfaqësuesve të qeverisë në bordet e administrimit të universiteteve. Sipas këtij reagimi, ky hap nuk do të ndërmerrej para se studentët të uletshin për dialog. "Kryeministria sqaron se lajmi për shkarkimin e përfaqësuesve të qeverisë në bordet e administrimit të universiteteve dhe drejtorët e konvikteve është i pavërtetë. Kryeministri Rama rithekson se është në pritje të hapjes së dialogut, përpara hedhjes së hapave konkretë për 8 pikat dhe pikave të tjera të Paktit për Universitetin", thuhet në njoftimin e Kryeministrisë.



Kryeministri Edi Rama

REAGIMI

"Lajmi për shkarkimin e përfaqësuesve të qeverisë në bordet e administrimit të universiteteve dhe drejtorët e konvikteve është i pavërtetë. Kryeministri Rama rithekson se është në pritje të hapjes së dialogut, përpara hedhjes së hapave konkretë për 8 pikat dhe pikave të tjera të Paktit për Universitetin".

SHKURTE

Qeveria, 8 miliardë lekë për kompensimin e pronave, kush përfiton

Këshilli i Ministrave ka miratuar dje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtime informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë, Shkodër, Lezhë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë Vorë. Masa e kompensimit është 59 975,25 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 801 927 925,69 lekë. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet pa leje shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pas miratimit nga kreditori. Gjithashtu, për një sërë parcelash, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit.

Zv.kryetari i EPP me Bushatin: Opozita të kthehet në Kuvend

Zëvendëskryetari i EPP, Joseph O'Reilly i bën thirrje Opozitës të kthehet në Kuvend. Deputeti i PS, Ervin Bushati, postoi thirrjen e O'Reillyt sipas të cilit senatori u shpreh se është tejet optimist për të ardhmen e Shqipërisë në BE, madje ai shtoi se kjo është vetëm çështje kohe. "Ai kërkoi nga simotra e tij e djathtë: Opozita duhet të hyjë sa më parë në Kuvend. Shqipëria në BE është çështje kohe! Senator O'Reilly u shpreh se është tejet optimist për të ardhmen e Shqipërisë në BE, madje ai shtoi se kjo është vetëm çështje kohe. Realizimi me sukses i reformave të ndërmarrja, si garantimi i të drejtave të njeriut, Reforma Zgjedhore me testim për votimin elektronik, si dhe votimin e emigrantëve, transparenca në financimet publike, reforma në drejtësi etj., janë hapat konkretë që na afrojnë me BE-në".

Patozi, Ramës: Tërhiq padinë ndaj Tupes

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Astrit Patozi, reagoi dje për protestën e studentëve, duke akuzuar kryeministrin Edi Rama se ai është shkak për kryesor i situatës që ndodhemi sot. Patozi në një postim në "Facebook", shkruan: "Tërhiq menjëherë atë padinë e turpshme për Edmond Tupen dhe të tjerët, që akuzohen si organizator të palligjshëm, sepse kjo gjë është plotësisht në dorën tënde dhe nuk ka nevojë as për dialog dhe as për negociata me studentët. Për ta bërë atë nuk të duhet që të marrësh kohë dhe as që të zhvendosësh fondet në buxhet e aq më pak të ndryshosh legjislacionin". Sipas tij: "Bëje një herë atë dhe pastaj filloje nga e para t'u lutesh dhe përgjeroresh që ata të vijnë të ullen e të bisedojnë me ty për 8 pikat e tjera që mbeten. Duke pranuar tërthorazi, se qeveria jote ju vetëm ka nisur të fusë ujë nga të katërta anët, por edhe ka filluar të çmendet".



2 milionë lekë kompensim për familjarët e agjentëve sekretë

Familjet e punonjës të civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), që humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj, si dhe familja e personit civil që ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me këtë agjenci dhe humbet jetën për shkak të këtij bashkëpunimi, do të trajtohen me kompensim të veçantë financiar. Kompensimi që përfiton familja me anëtarë bashkëshortor/bashkëshortin, fëmijët nën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur kryejnë studimet e larta, prindërit bashkëjetues dhe personat në kujdestari, në çastin e humbjes së jetës së punonjës të civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe personit civil që ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me këtë agjenci do jetë në masën jo më pak se 200 000 lekë për çdo anëtar.

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. bazuar në numrin 567.568 e vijues te K.P.T.C shqipti ankandin e pare për pasurine e pales debitore Sh"Strati Construcon" sh.p.k. K Strati dhe L Strati. Pasuria perbehet nga :
 -Ara ", Nr. pasurise 17222 ndodhur ne Drag dhe Durrës, Z.K.Nr. 1522, volumi 3, faqe 249, me sipërfaqe totale 1.000 m².
 -Ankand fillon me cmin fillistar ne masen 3.200.000 lekë.
 -Aparament ", Nr pasurise 116/61-1-19 ne Kyrjenodhej Kavaje , Z.K.Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, me sipërfaqe 33,19 m².
 -Ankand fillon me cmin fillistar ne masen 1.528.000 lekë.
 -Aparament ", Nr pasurise 116/61-1-20 ne Kyrjenodhej Kavaje , Z.K.Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, sipërfaqe 59,24 m² dhe Ankand fillon me cmin fillistar ne masen 2.720.000 lekë.
 Ankand qendron i hapur 15 dite dhe do te zhvillohet ne date 24.12.2018 ne orën 15:00 ne Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Traje: Ofertat duhet te behenqin dokumentacione te kompletuara me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-maili llir_devishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-at.com

Njoftim për shitje me ankand

Shqetria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. do te zhvilloje ankandin e pare te pasurise te pales debitore Shqetria "General Polymeren Recycling Albania" sh.p.k. e perbehet nga :
 -ARE", Nr pasurise 31/33, ne Z.K.Nr. 2255, volum nr.5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m², ne Koxhas, Durrës Ankand i pasurise fillon me cmin fillistar ne masen 163.615, 7 Euro.
 -ARE", Nr. n pasurise 31/4, ne Z.K.Nr. 2255, volum nr.1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12.900 m², ne Koxhas, Durrës. Ankand i pasurise fillon me cmin fillistar ne masen 300.105, 6 Euro.
 -ARE", Nr pasurise 31/3, Z.K.Nr. 2255, volum nr.1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4.300 m², ne Koxhas, Durrës. Ankand i pasurise fillon me cmin fillistar ne masen. 100.035, 2 Euro.
 Ankand do te zhvillohet ne date 24.12.2018 prej orës 15:00 ne selise Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kriktako tel. 003555672082543 ose ne faqen WEB www.powerjustice-at.com

UNAZA E MADHE PROTESTA

39 ditë protestë, qytetarët bllokojnë rrugët: Larg shtëpive tona, o hajdut!

Banorët e "Astirit": Rama ik, të rrëzohet projekti i Unazës

"Qendro dhe Gjikhuri të dorëhiqen"

Valentina Madani

Banorët e zonës së "Astirit" dolën sërish dje në protestë, duke u vendosur në të dyja asket e rrugës pranë mbikalimit në këtë zonë, duke bllokuar qarkullimin e mjeteve. Ata vijnë të kërkojnë dëmshpërblim 100% për shtëpitë, të cilat do të preken nga projekti, që sipas tyre, është i paligjshëm dhe i ndërmarrë vetëm për përfitime personale të qeverisë. Të veshur me jelekë fosforeshentë, banorët e Unazës së Re kërkuar edhe arrestimin e çdo politikani që sipas tyre është përfshirë projektin e Unazës së Madhe, konkretisht atë të kreut të ARRSH-së, Afrim Qendro dhe ministrit të Transporteve, Damian Gjikhuri. Ata përkrahen në kërkesat e tyre, sikurse janë përkrahur në më shumë se një muaj, edhe nga deputetë të opozitës, sikurse Klevis Balliu dhe Endrit Braimllari. Ky i fundit, sikurse banorët e zonës, shprehu mbështetjen e opozitës ndaj protestës studentore dhe u bëri thirrje politikaneve që të mësojnë nga organizimi i paqtë i tyre. "Larg shtëpive tona", "O Erion, o hajdut", "Shtëpia jonë është jeta jonë", "Na ndihmoni qytetarë të mbrojmë fëmijët tanë", këto janë disa nga parullat e banorëve që mbahen nëpër duar e brohoriten njëzëri. Protestuesit dogjën edhe goma në rrugë. Protesta tek Unaza e Re shënon ditën e 39, ndërsa banorët kundërshtojnë prishjen e banesave të tyre siç e parashikon plani për ndërtimin e aksit nga sheshi "Shqiponja", të mbikalimi pranë pallatit me shigjeta. Tanimë, ata kërkojnë edhe rrëzimin e projektit. Nga megafoni i protestës u kërka dorëheqja e kryeministrit Edi Rama; kreut të ARRSH-së, Afrim Qendro dhe Damian Gjikhurit, ministri i Transporteve, lidhur me falsifikimin e dokumenteve të një prej kompanive fituese të tenderit të një loti të rrugës. Banorët

shprehën solidaritet edhe me protestën e studentëve. "Studentët janë bijtë tanë", thirrën ata në kor. Në protestë ishin edhe deputetë të opozitës dhe bashkë me ta,

edhe kreu i opozitës, Lulzim Basha. Deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Endrit Braimllari përkrahu nga protesta e banorëve të Unazës së Re studentët,

duke u shprehur se politikanët duhet të marrin shembull nga mënyra paqësore dhe e organizuar e tyre. Më tej, Braimllari u shpreh se kryeministri Edi Rama nuk do t'ia dijë për qytetarët, pasi sipas tij, nëse do kishte interes për ta, do të kishte kontribuar deri më tani për mirëqenien e vendit dhe do t'ia kishte shmangur protestat e banorëve të Unazës së Re dhe të studentëve. "Ky vend ka të keqen e papunësisë, të varfërisë. Çdo e keqe tjetër lidhet së bashku me këto të përmendura dhe faktori ka vetëm një emër, Edi Rama", u shpreh deputeti i LSI-së. Banorët e mbështetën tanimë qëndrimin e tyre edhe të materialet e publikuara pak ditë më parë në emisionin "Të Paekspozuarit", të cilat ngritën dyshime për falsifikimin e dokumenteve në SHBA nga kompania fituese e lotit të parë të Unazës së Madhe me vlerë 18.8 mln euro, "DH Albania shpk".



Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha me banorët e Unazës së Re

Minatorët, LSI: Protesta, e vetmja mënyrë dialogu me Ramën

Zgjerohet harta e protestave në mbarë Shqipërinë. Edhe grupet e interesit janë ngritur në protesta kundër gjendjes së rëndë ekonomike. Më të fundit janë minatorët e Bulqizës, të cilët të rrënuar ekonomikisht nga puna e papaguar, kushtet e rënda të punës, nga çmimet e larta, rritja e taksave dhe papunësia janë ngritur në këmbë, duke protestuar në qendër të qytetit. Minatorët kërkojnë plotësimin e kushteve në punë si dhe statusin e tyre, uljen e çmimeve të larta, uljen e taksave. Këtë protestë e përshëndeti edhe deputeti i LSI, Përparim Spahiu, i cili shprehet se kjo është e vetmja mënyrë dialogu me kryeministrin. "Protesta, mënyra e vetme e



PROTESTA

Minatorët kërkojnë plotësimin e kushteve në punë si dhe statusin e tyre, uljen e çmimeve të larta, uljen e taksave. Këtë protestë e përshëndeti edhe deputeti i LSI, Përparim Spahiu, i cili shprehet se kjo është e vetmja mënyrë dialogu me kryeministrin.

dialogut me këtë qeveri. Mënyra e vetme e dialogut me arrogancën, mënyra e vetme e dialogut me mash-

trimin 10-vjeçar të KM aktual me minatorët për statusin!", shkruan deputeti i LSI.



Berisha: Edi Rama po përgatitet për azil politik

Ish-kryeministri Sali Berisha "ironizoi dje" shefin e Lekzekutivit, teksa shkruan se Edi Rama po përgatitet për të kërkuar azil politik. Përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", Berisha ka postuar një dixhiturë, e cila flet për vilën e kryeministrit në Surrël dhe që sipas Berishës, është nxjerrë në shitje për arsye emigracioni. "Rama përgatitet për azil politik! sb", thuhet në postimin e Berishës, i cili shoqëron dixhiturën e mëposhtme. Mes tjerash, në foton e publikuar jepjen detaje për vilën e kryeministrit, që nga hapësirat, arredimi e deri tek dokumentet dhe hipoteka.



Operacion 7 orë në Turqi, shërohet policja Ina Nuka

Policja Ina Nuka, e cila mbeti e plagosur pas shpërthimit të një kapsolleje në protestën e 22 nëntorit që u zhvillua para Kuvendit, i është nënshtruar sot një tjetër ndërhyrje kirurgjikale. Pas plot 7 orësh ndërhyrje në një spital në Ankara të Turqisë, 24-vjeçarja ia doli me sukses. Ky fakt është bërë i ditur nga zëdhënësi i Policisë së Shetit, Genti Mullai. Përmes një postimi në "Facebook" Mullai teksa ka uruar kolegjen e tij për një shërim të shpejtë, shton se ajo ia doli. Kujtojmë se për ngjarjen në fjalë u arrestua Daniel Droba, i cili u bë pjesë e protestës së banorëve të Unazës së Madhe që protestuan kundër shembjes së banesave të tyre. "Kolege, ja doli. Shërim të shpejtë dhe sa më parë rikthim në shtëpinë e Policisë, aty ku ëndrra jote do vijojë të realizohet. Besoj se rrjedha e furishme e përditshmërisë, shumëllojshmëria e ndodhive, eventimentet dhe hapësira kohore e fashitën sadopak ngjarjen para sallave plenare të Parlamentit të Shqipërisë, ku padrejtësisht e fatkeqësisht mbeti e gjymtuar një nga koleget tona, e re në moshë dhe në profesion, INA NUKA", shkruan Mullai.



NJOFTIM

Në datë 19.12.2018 në orën 16.00 në zyrën e përbaruesit gjyqësor privat Irlisa Tereziu PF me adresë në "Ruga Fadli Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhë, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankand për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Nderetese" me sip. Truallit 220 m2 dhe sip.nderetese 97 m2, me nr.pasurie 11/23, volum 10, faqe 229, zone kadastrale 8503, ndodhur ne Lagjia "Jani Vruhu", Berat. Cmimi ne ankand te parë është në vlerën 3,280,000 (tre milion e dyqind e tetedhjetë mijë) lekë.

"Kjo duhet të ndodhë në një sistem drejtësie që vepron nën sundimin e ligjit"

Dënimi i Emiljano Shullazit, reagon ambasada e SHBA-ve: Ne duhet të festojmë edhe vetë procesin

TIRANË

Një muaj pas dënimit me 55 vite burg të Emiljano Shullazit dhe katër anëtarëve të bandës së tij nga Gjykata e Krimeve të Rënda është përsëritur jo vetëm nga politika shqiptare, por edhe nga përfaqësia diplomatike e akredituar në Shqipëri. Ambasada amerikane ka reaguar sërish për këtë çështje, e cila përmes zvambasadorit në detyrë, Daniel Koski, është shprehur se të gjithë duhet të gëzojnë për procesin e drejtësisë. "Më 13 nëntor, Gjykata e Krimeve të Rënda dënoi Emiljano Shullazin dhe grupin e tij. Është e lehtë të gëzohesh për atë vendim, por ne duhet të festojmë edhe vetë procesin. Kishte diçka të thjeshtë dhe të thellë në atë proces, pavarësisht zhurmës që e rrethoi. Në fund, ishte diçka e zakonshme. Prokurorët paraqitën çështjen e tyre, gjykata e prezmoi të pandehurin të pafajshëm dhe lejoi një mbrojtje të fortë dhe gjykatësit dhanë vendimin bazuar mbi faktet dhe ligjin. I pandehuri ka gjithashtu të drejtën e apelit. Kjo duhet të ndodhë në një sistem drejtësie që vepron nën sundimin e ligjit. Kjo duhet të na japë shpresë të gjithëve ne", thuhet në njoftimin e ambasadës së SHBA-ve, shpërndarë në "Facebook".



Banda "Shullazi" në sallën e gjyqit

va, bindën gjykatësit e Krimeve të Rënda se një bos i kimit dhe kriminelë të tjerë e kanë vendin në burg. Përsëritës shqyrtimin e kujdesshëm të këtij rasti. Vendimi i marrë është një fitore për sundimin e ligjit në Shqipëri. Qytetarët shqiptarë tani pyesin "Kush e ka radhën?"

DËNIMI I GRUPIT "SHULLAZI"

Pas afro 50 seancash gjyqësore ka marrë fund saka "Shullazi" në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Në seancën e zhvilluar më 13 nëntor, kjo gjykatë dënoi me 14 vjet burg "kokën" e këtij grupi kriminal, Emiljano Shullazi. Ky i fundit u shpall fajtor për akuzat e gjobënieve dhe krijimit të grupit të strukturuar kriminal, ndërsa u shpall i pafajshëm për akuzën e presionit dhe kanosjes ndaj dy rektorëve Mynyr Koni e Dhori Kule dhe atë të shkatërrimit të pronës, për vendosje tritolit biznesmenit Jani Zaka në Tiranë dhe Adriatik Çuçuq në Lushnjë. Gjithashtu, trupa gjyqësore e drejtuar nga gjyqtari Fran Prendi dhe vendimet dhe për 4 anëtarët e tjerë të grupit në fjalë. Konkretisht, gjykata vendosi dënimin me 12 vite burg për Gilmando Danin, 10 vjet burg për Indrit Qyqjan, 10 vite burg

për Indrit Zelën si dhe 9 vite për Blerim Shullazin. Gjykata dha një masë shtrënguese, që të pandehurit të mos përfitojnë nga e drejta e lirisimit me kusht, ndërsa dënimin do e kryejnë në një burg jo të sigurisë së lartë. Në total, Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë 55 vite burg për anëtarët e bandës, ndërsa prokuroria

kërkoj 64 vite për 5 të pandehurit. Procesi gjyqësor u zhvillua nën masa të rrepta sigurie të Krimit e Rënda, ndërsa seanca u monitoruar nga përfaqësues të ambasadës amerikane dhe asaj gjermane. Trupit gjyqësor iu deshën rreth 3 orë e gjysmë për të marrë vendimin final për bandën e Emiljano Shullazit.

DËNIMET PËR GRUPIN "SHULLAZI"

1. EMILJANO SHULLAZI	14 VITE BURG
2. GILMANDO DANI	12 VITE BURG
3. ENDRI QYQJA	10 VITE BURG
4. ENDRI ZELA	10 VITE BURG
5. BLERIM SHULLAZI	9 VITE BURG

AMBASADA E SHBA-ve: KUSH E KA RADHËN?

Në një reagim në rrjetet sociale, më 14 nëntor të këtij viti, Ambasada e SHBA deklaroi: "Dita e djeshme shënoi një hap domethënës përpara për qytetarët shqiptarë, që kërkojnë dhe meritojnë drejtësi të vërtetë nga sistemi i tyre gjyqësor. Ne u inkurajam nga puna e prokurorëve shqiptarë, të cilët duke u bazuar në prova, bindën gjykatësit e Krimeve të Rënda se një bos i kimit dhe kriminelë të tjerë e kanë vendin në burg. Përsëritës shqyrtimin e kujdesshëm të këtij rasti. Vendimi i marrë është një fitore për sundimin e ligjit në Shqipëri. Qytetarët shqiptarë tani pyesin "Kush e ka radhën?"

OSBE: Do vijojmë të mbështesim reformën në drejtësi

Krijohet Këshilli i Lartë Gjyqësor, zgjidhen 6 anëtarët e rinj nga radhët e gjyqtarëve



Votimi i djeshëm për zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ-së

lit të Lartë të Gjyqësor ka reaguar OSBEE-ja. Në reagim, OSBE thotë se mirëpret ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, institucione të cilat sipas saj janë the-melore në një sistem drejtësie plotësisht funksional, të pavarur, profesional dhe të besueshëm. "Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të vijojë të mbështesë reformën në drejtësi, e cila do të mund të quhet e përfunduar vetëm atëherë kur të ndihet nga qytetarët shqiptarë, në jetën e tyre të përditshme, në mbarë

vendin", - thuhet ndër të tjera në reagimin e OSBE-së. **REAGIMI I SHBA**
"Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë mirëpret krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ne përgëzojmë prokurorët dhe gjykatësit që morën pjesë në votim për kurajon e tyre dhe që zgjedhën të ndryshojnë historinë e Shqipërisë. Krijimi i Këshillave shënon një hap vendimtar në zbatimin e reformës në drejtësi të Shqipërisë, e cila zëvendëson një

sistem të prishur me një sistem me integritet, i cili përmbush dhe u shërben nevojave të qytetarëve shqiptarë. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë dy shtyllat e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe cilësor. Ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë do të mundësojë tani krijimin e Strukturës Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, si edhe zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm të përhershëm. Këto institucione të drejtësisë janë të gjithë gurë të rëndësishëm në ndërtimin e shtetësisë së drejtësisë. Aktorët kombëtarë duhet tani të konsolidojnë këtë përparim të reformës në drejtësi, përfshirë edhe nëpërmjet rekrutimit dhe emërimit të magistratëve të rinj, gjë që është vendimtare për funksionimin e gjyqësorit. Një gjyqësor i fortë dhe i pavarur është kritik për të sjellë për popullin shqiptar rezultate në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Shtetet e Bashkuara mbe-tën plotësisht të angazhuara në mbështetjen e Shqipërisë për ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe cilësor, i cili sjell drejtësinë për të gjithë qytetarët shqiptarë".

NJOFTIM

Në datë 18.12.2018 në orën 16.00 në zyrën e përbaruesit gjyqësor privat Insa Terezi PF me adresë në "Rruga Fadli Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhë, Njësia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Ndentesë" me sip. Truallit 300 m2 dhe sip.ndentesë 120 m2, me nr.pasurie 522/10/1, volumn 6, faqe 2, zonë kadastrale 1167, ndodhur ne Bërxull, Tiranë.Cmimi ne ankand te parë është në vlerën 3,940,248 (tre milion e nëntëqind e dyzet mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 20.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi I I-rë për shitjen e 4 pasurive të paluajtshme , në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K me vlera fillestarë ne ankand: a) 252,668 (Dyqind e pesëqindet e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëqindet e tetë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,795 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547766, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 b) 244,532 (Dyqind e dyzet e katër mijë e pesëqindet e tridhjetet e dy) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,705 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547767, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 c) 316,400 (Treqind e gjashtëmbëdhjetet mijë e katërqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 3,500 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547772, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 c) 135,600 (Njëqind e tridhjetet e pesë mijë e gjashtëqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 1,500 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547773, Vol.19, Fq.147, ZK.2704.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

PENSIONISTËT VENDIMET E QEVERISË

Këshilli i Ministrave: Paratë mund t'i tërhiqni brenda dhjetorit. Fondi 3.278 miliardë lekë

Zbardhet vendimi: 50 mijë lekë të vjetra shpërblim për pensionistët

Tabela e plotë, cilat janë kategoritë që e përfitojnë



Foto ilustruese

Brenda muajit dhjetor, pensionistët në mbarë vendin do të marrin 50 mijë lekë të vjetra shpërblim për festat e fundvitit. Ky vendim është marrë ditën e djeshme nga Këshilli i Ministrave dhe është miratuar nga kryeministri i vendit Edi Rama. "Gazeta Shqiptare" publikon sot të gjitha kategoritë që do të kenë mundësinë të marrin këtë shpërblim. Fondi për shpërblimet e pensionistëve do të përballohet nga buxheti i sigurimeve shoqërore e llogaritet në vlerën 3 miliardë e 278 milionë lekë. "Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2018, ato të paguhën gjatë vitit të ardhshëm. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Posta Shqiptare, s.h.a., dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore". nënvizohet në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Voltiza Duro

**VENDIM
PËR
SHPËRBLIMIN E PENSIONISTEVË PËR FESTAT E FUNDVITIT 2018**

Ne mbledhëse të nënt 100 të Kushtetutës, të nënt 5, të ligjit nr.9036, datë 26.6.2006, "Për menaxhimin e saktimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të ligjit nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Kreshnik Ismajli;

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 5.000 (pesë mijë) lekë, të pensioneve, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që marrin pension pleqërie, pension shpërblyer, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) Personat që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe sipas paragrafit të katërt, të nënt 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) Personat që marrin pension, sipas ligjit nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar;

d) Personat që marrin pension, sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësit të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

e) Personat që marrin pension të parashikuar për veterani shtetasi, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

Faksimile e vendimit të Këshillit të Ministrave

50

MIJË LEKË SHPËRBLIM

Pensionistët në mbarë vendin do të marrin 50 mijë lekë të vjetra shpërblim për festat e fundvitit. Ky vendim është marrë ditën e djeshme nga Këshilli i Ministrave dhe është miratuar nga kryeministri i vendit Edi Rama.

KATEGORITË PËRFITUESË TË SHPËRBLIMIT

a) Personat që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) Personat që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe sipas paragrafit të katërt, të nënt 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) Personat që marrin pension, sipas ligjit nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar;

d) Personat që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

e) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr.190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".

Ja si do të merren lekët, masat e parave

Këshilli i Ministrave: Çeku i bebeve hyn në fuqi nga 1 janari i 2019

Ditën e djeshme, Këshilli i Ministrave ka miratuar masën e bonusit për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij. Respektivisht me lindjen e fëmijës së parë, nënat do të marrin bonusin prej 400 mijë lekësh të vjetra; për lindjen e fëmijës së dytë do të marrin 800 mijë lekë të vjetra; për lindjen e fëmijës së tretë dhe fëmijëve të tjerë në vijim do të marrin 120 mijë lekë të vjetra; ndërsa për nënat që lindin trinjakë dhe më shumë, masa e përfitimit do të jetë në masën 120 mijë lekë të vjetra për secilin fëmijë. "Ndimën e menjëhershme financiare (bonus) sipas pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe nënat shtetase shqiptare për fëmijë të lindur jashtë vendit dhe të regjistruar sipas afeteve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile. Pas regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile do të kryen verifikimet e nevojshme për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonus) sipas pikës 1, të këtij vendimi", theksohet në vendim. Gjendjes Civile.

ÇEKU

Masa e ndihmës së menjëhershme financiare do të jepet në formën e një çeku në emër të nënës, dhe ose sipas rasteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, dhe të paguheshmë: 35 lekë të reja menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit "certifikatë asistence në lindje"; 75 mijë lekë të reja menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit "certifikatë asistence në lindje"; diferenca e mbetur prej 5 mijë lekësh të reja, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile./

vo.du.

KUSH E PËRFITON?
Përkatësisht 50 mijë lekëshin do e marrin të gjithë personat që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social. Të drejtën për të përfituar shpërblimin në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona që kanë datë të fillimit të pensionit deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
"Shpërblimin e fundvitit e marrin edhe individët që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar.", theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Edhe personat që marrin pension, sipas ligjit

nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit

nr.9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar kanë të drejtë të marrin shpërblimin e fundvitit. Ndërkohë këtë të fundit mund ta tërheqin edhe personat që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr.10142,

datë 15.5.2009, "Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në

Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Kategoria e fundit e individëve që mund të marrë shpërblimin prej 50 mijë lekësh të vjetra është ajo e personave që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr.190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit

nr.7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë".



INVALIDËT

Personat të cilët kanë përfutur ose do të plotësojnë kushtet për të përfutur pension invaliditeti, kanë të drejtën e përfutimit të shtesës mbi pension në masën 1% për çdo vit vjetërsi pune në miniera në nëntokë, industrinë e naftës dhe në metalurgji.



LLOGARITJA

Llogaritja e pensioneve do të bëhet nga organet e sigurimeve shoqërore, ku kërkuesi ka qendrën e tij të banimit, njëlloj si për pensionet e pleqërisë, në varësi të momentit kur subjekteve përfutuese i lind e drejta për përfutim të pensionit.

Minatorët, naftëtarët dhe metalurgët do të përfutjnë pension suplementar

Projektligji, rritje pensioni deri në 20% për 26 mijë persona

Masa nga 0.6 deri në 1 për qind për çdo vit

Më shumë se 26 mijë persona që kanë punuar apo punojnë ende në miniera, industrinë e naftës, gazit dhe në metalurgji do të kenë mundësi të përfutjnë pension suplementar, përveç masës së përfutimit që marrin nga pensioni i pleqërisë. Ministria e Financave ka përgatitur projektligjin që u jep mundësi këtyre kategorive që kanë kryer apo kryejnë ende punë të vështira në këta tre sektorë të veçantë të ekonomisë për të pasur një trajtim financiar më të mirë se sa ai që kanë pasur deri më tani. Kështu, përveç pensionit të pleqërisë, masa e pensionit suplementar që do të marrin sipas këtij drafti varion nga 0.6 deri në 1 për qind shtesë për çdo vit pune në profesion të siguruar.



Foto ilustruese

të bëhet sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 150/2014 "Për pensionet e punonjëseve që kanë punuar në miniera në nëntokë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Ndërsa për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit në profesione e punë që hyjnë në kategorinë e parë, moshja për burrat për të dalë në pension është 55 vjeç dhe për gratë 50 vjeç, ndërsa periudha e përgjithshme e sigurimit respektivisht do jetë 30 vjet dhe 25 vjet. Nga këto, vjetërsia në punë të kategorisë së parë do jetë 15 vjet për burrat dhe 12.5 vjet për gratë. Ndërsa për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit në profesione e punë të kategorisë së dytë, moshja e daljes në pension do jetë 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë. Ndërkohë që periudha e sigurimit të përgjithshëm do jetë 30 vjet për burrat dhe 25 vjet për gratë, ndërsa vjetërsia në punë do jetë respektivisht 20 dhe 15 vjet. Të njëjtat kritere dhe periudha përcaktohen edhe për ish-punonjësit që kanë punuar në metalurgji. Ish-punonjësit e nëntokës, sipas përcaktimeve në këtë ligj të cilët kanë përfutur, ose do të plotësojnë kushtet për të përfutur pension pleqërie sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përfutjnë shtesë pensioni për çdo vit periudhë sigurimi 1% e masës së pensionit të pleqërisë. Ndërsa punonjësit e industrisë së naftës e gazit dhe punonjësit e metalurgjisë 0,6% e masës së pensionit të pleqërisë për çdo vit pune në profesion të siguruar. Nisur nga dyshemeja e viteve në profesion që është 12.5 vjet, rezultoi se masa më e ulët e përfutimit do jetë 12.5 për qind e pensionit të pleqërisë, ndërsa masa maksimale mund të shkojë deri në mbi 20 për qind, kjo në varësi të viteve të punës në profesion.

Nisma ligjore, ndarja e përfutuesve sipas çdo kategorie

Rëferuar kushteve për pension, bazuar në të dhënat që disponohen nga Instituti i Sigurimeve, si dhe në numrin aktual të punësuarve në industrinë e naftës, parashikohet që numri i personave që përfutjnë të arrijë në rreth 7000, nga 9900 që përllogaritet të ishte para ndryshimeve me një efekt financiar vjetor rreth 750 milionë lekë. Në projekt të ligjit fillestar, efektet financiare ishin parashikuar rreth 400 milionë lekë. Në reduktimin e këtij numri ka ndikuar përjashtimi i disa profesioneve të caktuara, që më parë konsideroheshin të rënda apo edhe të përjashtimi nga kjo skemë e personave që kanë bërë falsifikime dokumentacioni. Ndërkohë që numri i përfutuesve minororë parashikohet të jetë rreth 16 mijë persona dhe efekti përllogaritet rreth 530 milionë lekë në vit, ndërsa për metalurgjinë, numri i përfutuesve parashikohet të jetë rreth 2500 me një efekt financiar rreth 250 milionë lekë. Procedura e aplikimit, dokumentacioni i kërkuar, si dhe procedura e llogaritjes së pensionit do të përcaktohen me Rregulloret të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe përfutim të do të jenë objekt auditimi nga strukturat audituese të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Përfutimi nga ky ligj do të bëhet vetëm me aplikim të personave të interesuar.

suarit kanë kryer aktivitet ekonomik, në subjekte me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror si dhe në subjekte private. Periudhat e sigurimit të pambuluar me kontribute të paguara në fondin e sigurimeve shoqërore nuk njihen të vlefshme për këtë projektligj.

MASA E PËRFUTIMIT

Personave të këtyre tri kategorive u sigurohen përfutime

suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në tri mënyra, si pension për shkak të profesionit (lojti të punës), shtesë mbi pensionin e pleqërisë dhe shtesë mbi pensionin e invaliditetit. Përcaktimi i vjetërsisë për ish-punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë do të vazhdojë

PROJEKTIGJI

NENI 2 Përfutuesit

Përfuties sipas këtij ligji janë personat që kanë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë ligj, kur kanë punuar në punë dhe profesione, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji, si më poshtë:
a) Pensionistët, që kanë përfutur pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
b) Pensionistët që kanë përfutur pension sipas ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjëseve që kanë punuar në miniera në nëntokë"
c) Punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë.
d) Punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhinierio-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikës, gjeofizikës kantieriale, përpunimit dhe transport me naftësjelles dhe gazsjelles.
e) Punonjësit që kanë punuar në metalurgji në profesione, punë dhe ndërmarrje sipas përcaktimeve në kreu III, VII dhe XIII të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni".

NENI 5

Ish-punonjësit e përcaktuar në nenin 2, të cilët kanë periudha sigurimi sipas përcaktimeve në nenin 3 të këtij ligji, kanë të drejtën e përfutimeve të pensionit për shkak të profesionit apo shtesës mbi pension, kur plotësojnë kushtet si më poshtë:
I. Periudha e sigurimit dhe vjetërsia e punës në profesion.
a) Për ish-punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë, trajtimi me përfutimë përpara moshës dhe kushteve të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, do të vazhdojë të bëhet sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 150/2014 "Për pensionet e punonjëseve që kanë punuar në miniera në nëntokë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
b) Për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit në profesione e punë të përcaktuara në pasqyrën nr. 1 "Punë, që hyjnë në kategorinë e parë", kreu IV pika 2 dhe 3 të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni" i ndryshuar, përcaktohen:
 Moshja: për burrat 55 vjeç dhe për gratë 50 vjeç. Periudha e përgjithshme e sigurimit: për burrat 30 vjet dhe për gratë 25 vjet. Vjetërsia në punë të kategorisë së parë: për burrat 15 vjet dhe për gratë 12.5 vjet.
c) Për ish-punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit në profesione e punë të përcaktuara në pasqyrën nr. 2 "punë që hyjnë në kategorinë e dytë" kreu IV, në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni" i ndryshuar, dhe personeli inxhinierio-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, sipas listës së miratuar me VKM.
 Moshja: Për burrat 60 vjeç dhe për gratë 55 vjeç. Periudha e sigurimit: Për burrat 30 vjet dhe për gratë 25 vjet. Vjetërsia në punë të kategorisë së parë: Për burrat 20 vjet dhe për gratë 15 vjet.
 Kur nuk plotësohen kushtet e pikës "1" periudha e punës sipas asaj pike, i shtohet periudhës së punës sipas përcaktimeve në pikën "2". Në këtë rast kushtet e përfutimit janë ato sipas pikës 2-të më sipër shënuar.
 Ish-punonjësit që kanë punuar në metalurgji në profesione, punë dhe ndërmarrje sipas përcaktimeve në kreu III, VII dhe XIII të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni".
 Moshja: Për burrat 60 vjeç dhe për gratë 55 vjeç. Periudha e sigurimit: Për burrat 30 vjet dhe për gratë 25 vjet. Vjetërsia në punë të kategorisë së parë: Për burrat 20 vjet dhe për gratë 15 vjet.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS




Kompania që është nën hetim nga Prokuroria e Tiranës fitoi tenderin e Unazës

Skandali me tenderat, ARRSH padit në prokurori kompaninë "DH Albania"

Firma fitoi tenderin 11 milionë euro nga OST

Autoriteti Rrugor Shqiptar kallëzoi penalisht në Prokurorinë e Tiranës kompaninë "DH Albania". ARRSH kërkon hetimin e kësaj shoqërie për dy vepra penale, që lidhen me falsifikimin e dokumenteve dhe mashtrimin. Autoriteti Rrugor pranon në shkresën dërguar prokurorisë se kompania është themeluar në datën 25 qershor të vitit 2018, disa muaj përpara shpalljes së tenderit për lotin e parë të Unazës së Madhe, me vlerë 18 milionë euro, ku dhe është shpallur fituese. Por, ARRSH nënvizon se dokumentet e paraqitura nga kjo firmë kanë qenë të falsifikuara. "Këto veprime nënvizion ARRSH - dëmtojnë imazhin e institucionit tonë dhe buxhetin e shtetit". Po ashtu, Autoriteti Rrugor Shqiptar i ka nisur një shkresë Agjencisë së Prokurimit Publik për të përfshirur nga tenderat bashkimin e kompanive "Biba X" dhe "DH Albania" dhe pritet të shpallë së shpejti rihapjen e tenderit për lotin e parë të Unazës së Madhe. Përmes dokumenteve të falsifikuara, "DH Albania" ka fituar edhe tenderin prej 12 milionë eurosh të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për linjën 220 kilovolt Burrel-Peshkopi, procedurë kjo e anuluar dhe tenderi është rihapur këtë të mërkurë. Pritet që edhe OST të dorëzojë në prokurori dokumentacionin për tenderin e fituar nga "DH Albania". Si ARRSH, ashtu edhe OST kanë dërguar zyrtarisht kërkesën për të vjelë



garancinë e kontratës të lënë nga "DH Albania", vlera e së cilës arrin në afro 4 milionë euro. Kjo garanci vlen për të

dy tenderat që kanë një vlerë prej 30 milionë eurosh. "Zëri i Amerikës" raportoi të martën se ka dyshime të forta që pas




kompanisë "DH Albania" fshihet biznesmeni i njohur Bashkim Ulaj. Sipas "Zërit të Amerikës", para një muaji për-

SKANDALI U DENONCUA NE "NEWS 24"

Skandali i mashtrimit me tenderin për Unazën e Madhe u denoncu në emisionin të "Të Paekspozuarit" në "News 24". Ndërkohë, hetime për kompaninë në fjalë po kryhen edhe në SHBA. Më herët, zyra e sekretarit të Shtetit në Delaware konfirmoi se ka filluar hetimet për të përcaktuar nëse kompania "Dunwell Haberman", ose ndonjë prej zyrtarëve të saj është përfshirë në aktivitetet të paligjshme, mashtrime ose falsifikime.

ter", në pronësi të zotit Ulaj. Po ashtu, "Zëri i Amerikës" bën edhe një lidhje tërës mes kompanisë "Gener 2" të Ulajit me skandalin e tenderit të lotit të parë të Unazës së Madhe, duke thënë se bilanci i kompanisë "Dunwell Haberman", i dorëzuar në Qendrën e Regjistrimit të Bizneseve rezultoi të jetë përkthyer nga zozja Shenda Kruja, e cila nuk figuron në listën e përkthyesve zyrtarë, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë dhe rezultoi në rrjetet sociale si specialiste pranë kompanisë "Gener 2". Kontrata e "DH Albania" po hetohet edhe në Shtet e Bashkuara të Amerikës, pasi kjo kompani rezultoi se ka falsifikuar edhe një certifikatë të sekretarit të Shtetit të Delaware, që vërtetonte se ajo nuk kishte detyrime fiskale. Në Shqipëri, prokuroria po heton edhe për akuzat për shpërdorim detyre dhe shkelje të barazisë në tendera.

faqësuesi i firmës "DH Albania", 26-vjeçari Avdiol Dobi e ka transferuar adresën e tij në kullën "ABA Business Cen-

Consultant services for the project "Energy Efficiency Rehabilitation Programme Student City I - Tirana" Deadline: January 28th of 2019

Country: Albania
Ref.-N°: 201568179
Prequalification

Ref.: International, open tender for implementation consultant services for the project "Energy Efficiency Rehabilitation Programme Student City I - Tirana".

Tenderer: Ministry of Infrastructure and Energy, the City of Tirana and the Student City Administration (Programme Implementation Unit).

Project Objectives:
The objective of the project is to increase the structural integrity, energy efficiency, and basic comfort of the dormitory buildings in Student City 1, and university campus located in the South East of Tirana. More specifically, the scope of the works includes (1) modification of present floor plans, (2) refurbishment of the power, heating and hot water supply, (3) improving the access to fire escape ways, (4) interior refurbishment, and (5) end-user training and project visibility measures.

Requested Services:
The consulting assignment will generally comprise design, procurement and works supervision (implementation consulting) services required for the rehabilitation of Student City 1. More specifically, the implementation consulting services will consist of (1) structural and energy audits, (2) identification of rehabilitation measures, (3) preparation of the final design, (4) preparation of tender documents, (5) supervision of construction works, (6) training of end-users, (7) impact verification and monitoring, (8) qualification and employment opportunities, (9) visibility measures, and (10) reporting.

The scope of the services will be divided into base and optional services, with a total duration estimated at 30 months, excluding the defects liability period. The assignment shall be implemented by a team comprising international and local consultants and other professional and administrative support staff. Additional details regarding the services and the required qualifications of the bidders are provided in the Prequalification Document.

The prequalification of experienced Consultants is subject to the regulations contained in the "Guidelines for Assignment of Consultants in Financial Co-operation Projects" (see www.kfw-entwicklungsbank.de). The contract will be awarded to a consultant firm or a consortium of firms fulfilling the criteria stipulated in the Prequalification Document, including a minimum average annual turnover in the past three years of 1.5 million EUR for a single firm or cumulatively of 1.8 million EUR for a consortium, whereas the lead partner must show a total average annual turnover of at least 1.2 million EUR.

For further information and to obtain the Prequalification Document please contact:
Mr. Alfred Bundo
Director, Programme Implementation Unit
Ministry of Infrastructure and Energy of Albania
Address: Rr. "Abdi Toptani" Nr. 1,
Tirana, Albania 1001
E-mail: alfred.bundo@infrastruktura.gov.al
Phone: +3554 222245/74117

Mashtrim me datën e krijimit, figuron e regjistruar para 6 muajsh

Hetim firmës "Dunwell Haberman" në SHBA, për falsifikim dokumentesh

Shqipëria duket se po ndeshet me një skandal të ri korupsioni, lidhur me një prej kompanive që ka fituar tenderin për një prej segmenteve të Unazës së Madhe në Tiranë. Kompania shqiptare funksionon si degë e një kompanie të regjistruar në shtetin Delaware në Shtet e Bashkuara. Zyra e sekretarit të Shtetit në Delaware konfirmoi për "Zërin e Amerikës" se ka përfunduar hetimet për të përcaktuar nëse kompania "Dunwell Haberman", ose ndonjë prej zyrtarëve të saj është përfshirë në aktivitetet të paligjshme, mashtrime ose falsifikime. U vërtetua se kompania kishte falsifikuar dokumentacionin e saj. Firma "Dunwell Haberman" vepron në Shqipëri përmes filialit të saj vendës "DH Albania", e cila ka fituar një tender prej rreth 20 milionë dollarësh për një prej segmenteve të Unazës së Madhe në Tiranë. Firma dyshohet se ka kryer dy falsifikime për të siguruar kontratën në Shqipëri. Ka falsifikuar datën e krijimit. Në Delaware kompania figuron e regjistruar para 6 muajsh, në 25 qershor 2018, ndërsa në Shqipëri ka depozituar dokumente sikur ekziston që



KOMPANIA

Kompania shqiptare funksionon si degë e një kompanie të regjistruar në shtetin Delaware në Shtet e Bashkuara. Zyra e sekretarit të Shtetit në Delaware konfirmoi për "Zërin e Amerikës" se ka përfunduar hetimet për të përcaktuar nëse kompania "Dunwell Haberman", ose ndonjë prej zyrtarëve të saj është përfshirë në aktivitetet të paligjshme, mashtrime ose falsifikime.

nga qershori i 1998-ës. Dokumenti i dytë, që dyshohet të jetë falsifikuar është një certifikatë e sekretarit të Shtetit se kjo firmë nuk ka detyrime fiskale shtetit. Zëdhënësi i sekretarit të Shtetit, Doug Denison, i tha "Zërit të Amerikës" se për certifikatën nuk ka pasur asnjë kërkesë nga firma dhe as nuk është lëshuar ndonjë dokument. Dokumentet e falsifikuara dolën për herë të parë në Shqipëri gjatë emisionit "Të Paekspozuarit", në televizionit "News 24".

Shpallet lista e këngëtarëve që do marrin pjesë, mes tyre artistët më në zë të muzikës

Në pritje të Festivalit të 57 të Këngës, pretendentja kryesore Jonida Maliqi

Ermal Meta, surpriza e natës së parë

Egla Xhemali

Në ndan gati një javë nga Festivali i Këngës së Radio Televizionit shqiptar. Ndryshe nga sa ishte thënë, organizatorët nuk e lanë publikun të presë më gjatë dhe këngët e 22 konkurrentëve u bënë publike në Youtube. Thuajse gjithçka është gati për të startuar edicionin e 57 të festivalit që do bëjë bashkë zërat më të njohur të muzikës shqiptare. Në mesin e artistëve pjesëmarrës spikasin emra të suksesshëm të muzikës si Vikena Kamenica, Bojken Lako, Jonida Maliqi, Elton Deda, Eranda Libohova, Soni Malaj, Orgesa Zaimi, etj. Duket se ky vit do ketë konkurrentë të fortë. Burime për "Gazeta shqiptare" kanë pohuar se pretendentja kryesore për të fituar festivalin e fundvitit është Jonida Maliqi me këngën "Ktheju Tokës". Pas një shkëputje prej disa kohësh nga muzika Maliqi është rikthyer fuqishëm për të marrë pjesë në festivalin e 57 të këngës. Surpriza më e madhe që do u bëhet teleshikuesve në këtë edicioni të 57-të mund të thuhet padyshim se është i ftuari special. Ermal Meta, cili vjen si këngëtar shqiptar që ia doli të shpalsë vlerat dhe talentin në vendin fqinjë, duke qenë një nga kantautorët dhe artistët më të mirë në Itali. Ai do të vijë në natën e parë të Festivalit të fundvitit edhe si fituesi i "Sanremos", duke i dedikuar mes një agjende të ngjeshur vëmendjen e duhur publikut shqiptar. Gjatë konferencës për shtyp të mbajtur ditën e djeshme u zbuluan, gjithashtu, emrat e prezantuesve të këtij spektakli, që sigurisht kanë një rol decisiv për të mbajtur ritmin e garës. Aktori Viktor Zhusti do të shënojë në këtë edicion eksperiencën e tij të dytë si moderator, pasi në Festivalin e 10-të të Këngës ai moderoi eventin me në krah aktoren Edi Luarasi. Natyrisht që publiku është kurioz për të mësuar se kush do e shoqërojë kësaj here aktorin në skenë. Përzgjedhja e këtij viti është jo e zakonit për Festivalin, pasi bëhet fjalë për një emër pothuajse të panjohur nga shqiptarët. Ana Gojla, aktore, producent



dhe këngëtare që jeton në Kanada. Është vetëm 22 vjeç dhe do të jetë në krah të Zhustit për të moderuar

një nga eventet më të mëdha muzikore në vend. Ajo është me origjinë shqiptare, dhe gjithën shqipe e ka mësuar

nga gjyshërit e saj. Gjatë natës së dytë krahas performancave të artistëve konkurrentë vetë prezantuesja Ana



Gojla do të ketë një numër special. Kujtojmë se vjet Shqipëria pati një përfaqësim dinjitoz në Eurosong me

këngën "Mali" të Eugent Bushpëpës që u prit mjaft mirë nga mbarë shtetet europiane dhe jo vetëm.

KËNGËT E KUALIFIKUARA NË FEST' 57

Këngëtar	Titulli	Kompozimi	Poeti
Aurel Thellimi	Te Dua Ty	Ardita Bufaj & Aurel Thellimi	Aurel Thellimi
Bojken Lako	Jeto Jeten	Bojken Lako	Xhevdet Bajraj
Bruno Pollogati	Nuk Ka Stop	Bruno Pollogati	Endrit Mumajes
Dilan Reka	Kama	Gridi Kraja	Florian Zyka
Eliza Hoxha	Pengu	Eliza Hoxha	Eliza Hoxha
Elona Islamaj	Ne Kete Bote Kalimtare	Elona Islamaj	Elona Islamaj
Elton Deda	Qetesisht	Elton Deda	Elton Deda
Eranda Libohova	100 Pyetje	Genti Myftaraj	Pandi Laco
Gjergj Leka	Besoje	Gjergj Leka	Gjergj Leka
Gr. Alar Band	Dashuria Nuk Mjafton	Elgit Doda	Klea Huta
Jonida Maliqi	Ktheju Tokës	Eriona Rushiti	Eriona Rushiti
Kelly (Florian Carkanji)	A Me Ndjen	Kelly	Kelly
Klint Collaku	Me Jete	Endrit Shani	Pandi Laco
Klodiana Vata	Mbremje E Pa Fund	Edmond Zhulali	Jorgo Papingji
Kujtim Prodani	Babela	Kujtim Prodani	Kujtim Prodani
Lidia Lufi	Rrefehem	Enis Mullaj	Lidia Lufi
Lorela Sejдини	Vetmi	Lorela Sejдини	Lorela Sejдини
Marko Strazimiri & Imbro	Leyla	Adrian Hila	Adrian Hila
Mirud	Nene	Elhaida Dani	Durim Morina
Orgesa Zaimi	Hije	Gentian Lako	Gentian Lako
Soni Malaj	Do Vij	Irkenc Hyka	Lindon Berisha
Vikena Kamenica	Naten E Mire	Vikena Kamenica	Vikena Kamenica



Tayna festë madhështore për ditëlindje, shihni si duket reperja

Mbrëmjen e kaluar reperja e famshme shqiptare Tayna, ka festuar ditëlindjen e saj të 22-të. Kjo ishte një festë tejet e bukur për këngëtarën dhe kjo është hera e parë që po e feston ditëlindjen si një vajzë shumë e famshme. Ajo e ka trajtuar veten si mbretëreshë për shkak se në kokë kishte vënë një kurorë gjigante, derisa ishte rrethuar me mikeshë dhe me një tortë me fishkëz-jarre që u ndezën për të. Këngëtarja e ka festuar ditëlindjen tre ditë më herët, sepse ajo realisht ditëlindjen e ka me 14-të dhjetor, ndërsa në 'Instagramin' e saj u publikuan ca video e imazhe nga festa e madhe që ajo organizoi.



Xhensila Myrtezaj u rikthehet projekteve muzikore, ja me kë këngëtar do bëjë duet

Këngëtarja e famshme shqiptare, Xhensila Myrtezaj pas lindjes së vajzës ka vendosur që të rikthehet me këngë të reja. Muaj më parë Xhensila u bë nënë e një vogëlusheje me emrin Ajka, tani po i rikthehet këngëve të reja. Ditën e djeshme nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale Xhensila Myrtezaj zbuloi se shumë shpejt do i rikthehet muzikës. Ajo ka publikuar një fotografi në 'Instagram' krah kantautorit Pirro Çako, me të cilin po bën këngë. Këtë e thonë burime të afërta me këngëtarët nga Revista Who, e cila shkruan se Pirro është ai që e ka shkruar dhe e ka kompozuar këngën, ndërsa dyshja janë parë edhe në studio bashkë.



Avokatë! Po jetën tuaj a e mbroni siç mbroni të drejtat e klientëve tuaj?



Me Sigurimin Jetë me Mbijetesë keni përfitim dyfish: sigurim jete dhe investim afatgjatë. Mbroni pasardhësit tuaj në rast të të papiturave dhe njëkohësisht investoni me një normë të garantuar interesi prej 1.2% në vit, në monedhat Lek, Euro ose Dollar. Primi vjetor minimal duke filluar nga 200 euro/vit dhe shumë sigurimi deri në 120,000 euro!



Sigurim për Jetën



Sigurim nga Aksidentet



Sigurim nga Sëmundjet Kritike



**SIGURIMI
JETË me MBIJETESË**

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Asnjë reagim nga Hungaria për ekstradimin e ish-kryeministrit

Arratisja e Gruevskit, prokuroria s'ka ende pamjet filmike nga Shqipëria

Një muaj pas arratisjes së ish-kryeministrit Gruevski, institucionet kompetente në Maqedoni, ende janë duke gjurmuar pas përgjigjeve. Nga prokuroria paralajmërojnë se rreth hetimeve për mënyrën e arratisjes do të prononcohen brenda dy javëve. Prokuroria ende nuk i ka në dispozicion video-xhirimet nga Mali i Zi dhe Shqipëria. "Kolegët dje kanë kërkuar nga Shqipëria të dorëzohen sa më shpejt materialet që i posedojnë. Kontrollimi i xhirimeve që i kemi është

ARRATISJA E GRUEVSKIT

Prokuroria ende nuk i ka në dispozicion video-xhirimet nga Mali i Zi dhe Shqipëria. "Kolegët dje kanë kërkuar nga Shqipëria të dorëzohen sa më shpejt materialet që i posedojnë. Kontrollimi i xhirimeve që kemi është drejt fundit. Presim që gjatë dy javëve të dalim me komunikatë për rezultatet e hetimeve". Nga Ministria e Drejtësisë thonë se nuk ka asgjë të re nga autorite-

të kah fundi. Presim që gjatë dy javëve të dalim me komunikatë për rezultatet e hetimeve". Nga Ministria e Drejtësisë thonë se nuk ka asgjë të re nga autorite-

tet e Hungarisë rreth kërkesës për ekstradimin e Gruevskit. "Ende nuk kam përgjigje nga Hungaria rreth kërkesës sonë për ekstradim. Por afatet nuk janë tejkaluar. Do të presim një periudhë të caktuar e më pas do të dërgojmë urgjencë". Derisa autoritetet në Maqedoni janë në përgatitje e sipër të rezultateve të hetimit, një fotografi e ish-Kryeministrit Gruevski në rrugët e Budapestit ka shkaktuar reagime të ndryshme. Për autenticitetin e kësaj fo-



Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikola Gruevski

tografie nga Budapesti, mediat thirren në konfirmimin e gazetarit britanik Den Nolan, i cili ka gjetur vendin e fotografisë, por nuk ka zbuluar se kush është autori. "E kapa" ka shkruar gazetari britanik në rrjetet sociale.

Shteti pagan 20 mijë euro në vit për pjesëmarrje në organizatë

Kosova do të rinegociojë marrëveshjen me CEFTA-n

Mulaj: Bizneset po humbin si pasojë e saj

Republika e Kosovës duhet të rinegociojë Marrëveshjen për Tregti të Lirë me vendet e Ballkanit Perëndimor, e njohur si CEFTA, pasi që nga nënshkrimi i saj, Kosova nuk është trajtuar e barabartë me vendet anëtare të kësaj marrëveshje, thonë ish-zyrtarë të qeverisë së Kosovës dhe ekspertë për çështje ekonomike. Sipas tyre, kjo marrëveshje është nënshkruar në kohë jo të duhur dhe në të shumtën e rasteve, kjo marrëveshje ka dëmtuar ekonominë e Kosovës. Rezultatet e marrëveshjes në atë kohë kanë qenë vetëm në aspektin politik dhe jo në atë ekonomik. Sa i përket shkëmbimeve tregtare të Kosovës me bllokun e CEFTA-s, Kosova ka raport jo të mirë në mes eksportit dhe importit. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se në vitin e kaluar importi i mallrave nga vendet anëtare të CEFTA-s ka qenë mbi 856 milionë euro, kurse eksporti i mallrave të Kosovës në vendet anëtare të kësaj marrëveshjeje, po në këtë vit ka qenë 183 milionë euro. Në këtë mekanizëm, përveç Kosovës anëtarë të tjerë janë: Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina dhe Moldavia. Ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, tha për Radion Evropë e Lirë se situata aktuale është shumë e favorshme që Kosova të tërhiqet nga ky mekanizëm dhe më pas të rinegociohet. Arsye e kësaj, sipas ish-ministrit, është se Kosova në këtë mekanizëm ende përfaqësohet si UNMIK dhe jo si Republikë e Kosovës. "Sa kam qenë ministër kam kërkuar që kjo marrëveshje të rinegociohet. Mirëpo tash pas situatës se krijuar, pas vendosjes se tarifës doganore 100 për qind për produktet më origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, është koha që Kosova të tërhiqet plotësisht nga CEFTA dhe më një mundësi rinegociojmë që kjo marrëveshje të nënshkruhet si Republikë e Kosovës. Shtetet e tjera anëtare të CEFTA-s kanë bërë shumë shkelje. Ko-



Eksperti për çështjet ekonomike, Ismet Mulaj

sova është injoruar, marrëveshja asnjëherë nuk është zbatuar nga shtetet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës", tha Hasani. Edhe Ismet Mulaj, ekspert për çështje ekonomike, thotë se për arsye politike dhe ekonomike, Kosova duhet të rinegociojë këtë marrëveshje. "E para arsye është ekonomike, për shkak se në kohën kur është negociuar marrëveshja e CEFTA-s, Kosova nuk ka mbrojtur asnjë produkt të vetin, për shkak se ka qenë viti 2007 dhe prodhimtaria e Kosovës ka qenë në hapat fillestar. E dyta është arsye politike dhe juridike. Kosova është i vetmi vend anëtar i CEFTA-s që merr

pjesë me (akronimin) UNMIK-un në tavolinën e CEFTA-s. Pra, zyrtarisht UNMIK është anëtar i CEFTA-s, kurse Kosova është pjesë e delegacionit të tij", shprehet Mulaj. Në këtë mekanizëm, Republika e Kosovës është anëtarësuar në vitin 2007. Për shkak se në atë periudhë Kosova nuk e kishte të zgjedhur statusin, marrëveshja ishte nënshkruar nga shefi i atëherëshëm i UNMIK-ut, Joachim Rucker. Kurse në aspektin ekonomik, Bajram Hasani, thotë se shteti i Kosovës ka përfutur më se paku nga shtetet anëtare të këtij mekanizmi. "Kosova nuk përfiton nga kjo marrëveshje, Kosova në vazhdimësi është dëmtuar

nga kjo marrëveshje", tha Hasani. Ndërkaq, Ismet Mulaj thekson se kjo marrëveshje, madje shumë herë, ka vështirësuar aktivitetin biznesor të prodhuesve kosovarë. Duke marrë parasysh gjendjen e rëndë të këtij sektori, prodhimet "Made in Kosovo" vështirë kanë depërtuar në tregun rajonal, kurse prodhimet e huaja pothuajse kanë mbuluar tregun vend. "CEFTA ka dëmtuar prodhuesit kosovarë. Për shkak se produktet rajonale dalin me çmim më të lirë në treg, pasi politikat e shteteve tjera janë që të subvencionojnë eksportin e produkteve të tyre. Ndërsa, Kosova nuk ka ndonjë politikë të subvencionimit, avokatitë apo promovimit të eksporteve tona në arenën ndërkombëtare", tha Mulaj. Institucionet e Kosovës paguajnë rreth 20 mijë euro në vit për pjesëmarrje në marrëveshjen e CEFTA-s. Qeveria e Kosovës e ka akuzuar disa herë Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën se nuk kanë zbatuar marrëveshjen e CEFTA-s apo me vështirësi prodhimet e Kosovës kanë hyrë në tregjet e tyre. Më 21 nëntor Kosova ka vendosur tarifa doganore prej 100 për qind për produktet më origjinë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Bashkimi Evropian i ka bërë thirrje që menjëherë t'i heqë këto tarifa, por kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se një gjë e tillë do të ndodhë vetëm kur Serbia ta njohë Kosovën./REL



Kryeministria: S'ka kohë për risi

48 deputetë kërkojnë largimin e Theresa May nga kryesimi i partisë

Shtyrja e votimit në parlament të marrëveshjes për Brexit, i ka kushtuar shtrenjtë kryeministres britanike Theresa May. 48 deputetë të partisë së saj Konservatore, kërkojnë largimin e shefes së qeverisë. May do të përballë këtë pasdite me një mocion mosbesimi, që mund të tronditë themelet e qeverisë britanike në kulmin e debatit për Brexit. E zënë ngushtë nga pjesa forcat rebele brenda Konservatoreve, kryeministria doli paraditen e së mërkurës në një deklaratë për shtyp, ku nënvizoi se një leadership i ri, është gjëja e fundit për të cilën Britania e Madhe ka nevojë tani. Theresa May, kryeministre e Britanisë së Madhe: Ndryshimi i leadershipit në këtë moment do të vinte në rrezik të ardhmen tonë. Lideri i ri nuk do të kishte kohë të rinegocioje Brexit, pra veprimi i tij i parë do të ishte shtyrja apo shfuqizimi i nenit 50. Nëse vota kundër May do të përbente shumicë, kryeministria do të ishte e detyruar të jepte dorëheqjen, për t'i hapur rrugë zgjedhjes për liderin e ri të Konservatoreve, për rrjedhojë kryeministritin e ri britanik. Nëse shefja e qeverisë arrin të shpëtojë, mandati i saj nuk mund të vihet për të paktën 1 vit tjetër.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

A. Project Background

Within the context of bilateral development cooperation, the Republic of Albania and the Federal Republic of Germany agreed on the joint implementation of the "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" program (short: ProSEED) in 2016. The overarching aim is to improve the employment situation of the workforce and self-employed, particularly of skilled youth, in the Albanian labor market.

The program currently runs from 01/2017 until 03/2022 and has five components: (i) Technical and Vocational Education and Training (TVET), (ii) Promotion of micro, small and medium-sized enterprises (MSMEs), (iii) Social participation of youth and minorities, (iv) Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment and (v) Promotion of the innovation system.

In 2018 the European Union (EU) contributed funds under the framework of the Instrument for Pre-Accession Assistance 2020 for the Competitiveness and Innovation (C&I) Sector. The delegated agreement-based co-financing extended the program by including measures to encourage innovative start-ups and to strengthening a corresponding environment (ecosystem) for start-ups and growing-in companies. As such, a fifth component (see above) was added to the ProSEED program.

One line of intervention within this component delivers advanced capacity development to innovative start-ups (including those owned and/or led by women). Start-ups at different levels of their development are selected upon their innovation and competitiveness potential in a competitive procedure. They will be supported on innovation management and in the field of advanced entrepreneurial skills. Furthermore, they will receive mentoring support for developing their product ideas and scaling-up. For this line of intervention, the position of an Advisor – Start-up promotion is hereby advertised.

GIZ Office Albania seeks the following staff: Advisor – start-up promotion

The advisor – start-up promotion performs the following tasks:

B. Tasks

Capacity development interventions for Start-ups

- Coordinates and accompanies the implementation of capacity development interventions for start-ups in the field of innovation management and advanced entrepreneurship support
- Supports the elaboration/definition of selection criteria for start-ups and supports/accompanies the selection process for start-ups for various training modules
- Develops a strategy for the support of women-led start-ups and respective support programmes; coordinates capacity development interventions and support structures/institutions for women-led start-ups
- Based on identified capacity development needs of start-ups; sub-contracts and coordinates external experts on specific Capacity Development / training issues

Networking

- Networks actively on behalf of GIZ in the relevant community and brings new expertise, ideas and trends to the project
- Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the project
- Stays in exchange with relevant training and support programmes/interventions from other stakeholders and institutions
- Assists the team leader in establishing and increasing the project's visibility among stakeholders of the start-up community and beyond

Others

- Supports program activities according to project goals, operational planning and agreements with the partner structures. This implies contributing to planning & budgeting, implementation and monitoring of activities
- Accompanies the financial and administrative issues regarding the assigned intervention areas in close coordination with the contract manager of the component.
- Supports the preparation of appropriate input to the various project reports/publications including annual reports in line with EU/GIZ requirements; contributes to other reports as required
- Assists in improving the project's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems

C. Required qualifications, competences and experience:

- **Education/training:** University qualification, e.g. in IT, Engineering, Business Administration, Political Science, International Relations, or equivalent
- **General professional experience:** at least 5 years of professional experience in developing start-up ecosystems, working in a start-up or participating in a start-up program with a strong focus on innovation and (digital) transformation
- **Languages:** Fluent in Albanian, excellent business language skills in English required
- **Specific professional experience:** Proven experience in developing innovation ecosystems, experience in private sector development, active member of the Albanian 'start-up scene', experience in the facilitation and creation of networks, applied knowledge in the field of project management

Contract conditions:

- Full-time employment
- Project office in Tirana
- Assignment period: until 30.09.2021

Please forward your application until **25th of December 2018** to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Eu-ropass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

I dyshuari është një 29-vjeçar i lindur në Strasburg

Gjenden lëndë shpërthyesë në shtëpinë e atentatorit të tregut të Strasburgut

Autoritetet franceze kanë gjetur materiale shpërthyesë në banesën e atentatorit të tregut të Krishtlindjeve në Strasburg, i cili është ende në arrati. Lajmin e ka bërë të ditur Stephane Morisse, anëtar i policisë së FGP. Zbulimi është bërë gjatë një kontrolli në banesë pak orë para sulmit. Forcat e rendit, ka thënë Morisse pa treguar detaje të tjera, kishin shkuar në shtëpi për të arrestuar 29-vjeçar-in. Më 11 nëntor i riu i lindur e rritur në Strasburg qëllon në mes të turmës në tregun e krishtlindjeve. Gjatë sulmit 4 persona humbën jetën dhe 13 të tjerë u plagosën. Sulmuesi i dyshuar u plagos gjatë një operacioni të policisë, por i dyshuari është një 29-vjeçar i lindur në Strasburg dhe që ndodhet ende në arrati. Ndërkaq forca të shumta policie kanë rrethuar Parlamentin Europian që e ka selinë në Strasburg. Ditën e sulmit, europarlamentarët, stafi shtesë dhe gazetarët e kishin të pamundur të dilnin nga ndërtesa pas informimit për të shtëna.



Presidenti i Parlamentit Europian Antonio Tajani ka shkruar në Twitter se Parlamenti në Strasburg nuk do të frikësohet nga sulme terroriste apo kriminale". Ai shprehu "dhimbje" për viktimat, duke shtuar se Parlamenti do të "vazhdojë të punojë dhe reagojë duke u forcuar nga liria dhe demokracia kundër dhunës terroriste". Zyra e prokurorisë së Parisit tha se sektori i saj antiterror është tani përgjegjës për hetimin.

Sulm edhe "Facebook"-ut

Zyra qendrore të Facebook në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë evakuuar pas një alarmi për kërcënim. Një telefonatë anonime njoftoi për një bombë në këto zyra. Në vendngjarje shkuan forcat policore dhe ekspertët anti-eksploziv, të cilët evakuuan të gjithë stafin dhe nisën kontrollin në ndërtesë. Alarmi rezultoi fals dhe nuk kishte asnjë rrezik për lëndë plasëse. Në këto zyra kishte edhe punonjës të Instagram, përveç atyre të Facebook. Pavarësisht se alarmi rezultoi fals, policia lokale vazhdon të monitorojë situatën. Mediat amerikane raportojnë se mundësia e një sulmi në kompaninë teknologjike duhet të merret në konsideratë, pas të shtënavave me armë që ndodhën në zyrat e YouTube në muajin prill, ku u vranë tre punonjës.



|| NJOFTIMI

Një telefonatë anonime njoftoi për një bombë në këto zyra. Në vendngjarje shkuan forcat policore dhe ekspertët anti-eksploziv, të cilët evakuuan të gjithë stafin dhe nisën kontrollin në ndërtesë. Alarmi rezultoi fals dhe nuk kishte asnjë rrezik për lëndë plasëse. Në këto zyra kishte edhe punonjës të 'Instagram'-it, përveç atyre të 'Facebook'-ut.

HISTORI

Fate të trishta, inxhinierët e Maliqit dhe Harry Fultz

Fatmira Nikolli

Pas shpalljes së vendimit për të dënuar grupin e inxhinierëve, Departamenti i Shtetit Amerikan nxori një deklaratë ku kategorikisht mohonte pohimet e bëra në gjyq. E publikuar në buletin mjor të këtij Departamenti, ajo thotë: "Gjykimet (e inxhinierëve) që po ndodhin në Tiranë janë padyshim një përpjekje e regjimit shqiptar për të përjetësuar veten me anë të shtypjes së terrorizimit të elementeve liberale, patriotike dhe opozitare shqiptare. Akuzat se ishin të lidhur me anë të pagesës ose shërbimit ndaj Shteteve të Bashkuara, apo të ndonjë përfaqësuesi të saj në Shqipëri nuk ka ndodhur në asnjë mënyrë dhe është krejtësisht e pavërtetë". Menjëherë pas ngjarjes në Shqipëri, anëtarët e misionit amerikan u drejtuan drejt Liberisë, ku në foto shihet edhe Harry Fultz, së bashku me të bijën. Një imazh i G.Henderson më 1946, e shfaq Fultzin të parin mes atyre që fotografohen. Ka ikur, ka lënë pas Shqipërinë dhe ka një tjetër mision. Studimi "Spiunë & sabotues: martirizimi i inxhinierëve të Maliqit" i Kejsi Ziut, është prezantuar në fund të tetorit në konferencën "Të mohuar nga regjimi": burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipërinë e viteve 1945-1990". Konferenca e organizuar Autoriteti i Dosjeve, pat si qëllim reflektimin në studime të jetës nën diktaturë, porë nga prizme të ndryshme. Puna e Ziut, vë përballë akuzave ndaj inxhinierëve përfshirjen e misionit agjenturial amerikan gjatë regjimit komunist në Shqipëri". Ajo pyet, nëse ishte grupi teknik i sabotuesve agjentë të misionit amerikan në Shqipëri apo instrument i përdorur nga regjimi për të eliminuar ndikimin e SHBA-së në Shqipëri? Ajo pyet nëse e përdori Sigurimi i Shtetit arrestimin e grupit të inxhinierëve të Maliqit për të larguar ndikimin e frymës perëndimore demokratike nga një Shqipëri që po kthehej në shtet-satelit të Bashkimit Sovjetik? Në fund, pyet nëse mund të flitet për ekzistencën e një "luftë të ftohtë agjenturiale" ndërmjet nga njëra anë Harry Fultz-it - një prej kontribuesve më të mëdhenj në edukimin e brezave të të rinjëve shqiptarë në fillimet e shtetit shqiptar, i cili akuzohej se po përpiqej të rekrutonte ish-nxënësit e shkollës së tij si spiunë të SHBA-së kundër regjimit komunist dhe nga ana tjetër, Sigurimit, i cili po krijonte rrjetin e tij të bashkëpunëtorëve për të mbajtur nën kontroll status quo-në?

STUDIUMI
 Studimi ka përfshirë disa burime, nisur që nga Fondi Arkivor i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, i cili ka në disponim dosjet survejuese dhe hetimor-gjyqësore të Sigurimit të Shtetit, tashmë të deklasifikuara. Njëherësh janë marrë në shqyrtim edhe dokumente të gjendura në Fondin e Arkivit Qendror të Shtetit Shqiptar (AQSH), në Arkivin e Shtetit Amerikan, si dhe disa



Foto e misionit amerikan në Liberi, 1946, menjëherë pas largimit nga Shqipëria. Fultz është renditur i pari, majtas (foto: G.Henderson).



Fotografi e Harry Fultz gjatë kohës kur ka qenë drejtor i Shkollës Teknikë në Tiranë

raporte të hartuara nga CIA, të deklasifikuara vitet e fundit dhe akte të ndryshme ligjore të periudhës komuniste, (Kushtetutat e viteve 1946 dhe 1976, si dhe akte ligjore të periudhës 1944-1946). Megjithatë në vitet 1944-1945 ende s'mund të flitet për një legjislacion të mirëfillt të punës, kjo e fundit udhëhiqej dhe bazohej te parimi i ideologjisë së klasës punëtore. Puna fizike dhe mendore ishte njëlojë e detyrueshme për t'u kryer në bazë të ligjeve dhe rregulave të përshtatura qëkur regjimi erdhi në pushtet në fundin e vitit 1944.

Me objektivin për të realizuar "ndërtimin socialist të vendit", si dhe nga ana e PPSH-së, u përdorën jo vetëm krahe pune me pagesë, por në shumicën e rasteve në sajë të punës së detyruar të të burgosurve politikë të arrestuar nga Sigurimi i Shtetit, në kampet e punës të shpërndara në të gjithë cepat e Shqipërisë. Ligji "Për krijimin e Policisë Popullore", autorizonte policinë të arrestonte individë dhe të dërgonte individë nëpër burgje apo kampe për pune të detyrueshme.

PUNA E DETYRUAR NË KAMPIN E MALIQIT
 Një raport i hershëm i qeverisë amerikane, adresuar Organizatës së Kombeve të Bashkuara detajonte kushtet çnjerëzore me të cilat trajtoheshin këta të burgosur në kampet e punës dhe të internimit. Raporti përshkruan gjendjen në kampin e punës së detyruar për tharjen e Kënetës së Maliqit, së cili i referohet si një prej "kampeve të vdekjes": "Të marra sot në shqyrtim, kushtet e punës atje do të binin në kundërshtim të hapur me Konventën për të Drejtat e Njeriut, ashtu si dhe me rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) mbi ndalimin e punës së detyruar sepse përveçse nuk garantonin mbrojtjen dhe sigurinë e duhur në punë, nuk respektonin as minimumin e dinjitetit njerëzor të të burgosurve. Konkretisht, atyre u duhej që shumicën e kohës të kryenin punë të rëndë fizike në ujë, pa veshjet e duhura të punës dhe me vegla primitive, në orare që i tejkalonin 10 orë në ditë, me shumë pak



pushime ndërmjet. U nënshtroheshin, gjithashtu, torturave të shumta fizike (deprivimi i ushqimit, i gjumit etj.) dhe psikologjike". Në përfundime të ngjashme arrin edhe një raport i mëvonshëm i Amnesty International (1984) për mënyrën e shfrytëzimit i punës së detyruar të të burgosurve politikë solli kontribute të konsiderueshme në ekonominë e vendit. Krijimi i kampeve të internimit ishte i modeluar nga ato të Bashkimit Sovjetik, siç vërtetohet edhe nga një raport i CIA-s, tashmë i deklasifikuar në 2013.

AKUZA
 Prokuroria pretendonte se H. Fultz kishte krijuar një organizatë me elementë teknikë - intelektualë, në krye të së cilës ishin ish-nxënësit e tij, me qëllimin e të qenit gatim në momentin kur qeveria e atëhershme, që ishte ende e përkohshme, të zëvendësohej me një qeveri pro anglo-amerikane. Puna e kësaj organizate do të përmblidhej në sabotimin indirekt të ndërtimit të vendit, me rrjedhojë pasoja të dëmshme për qeverinë për sa i përket ekonomisë dhe vijës së saj politike. Akuzat që ngrihej mbi grupin e inxhinierëve ishte e rëndë. "Këta persona akuzohen për shkak se kanë kryer: a) Vepra sabotazhi në stil të gjërë dhe në mënyrë sistematike; b) Vepra spiunazhi në favor të agjentëve të huaj; c) Kanë formuar një grup teknik-profesional për të

sabotuar rindërtimin, fuqinë ekonomike të vendit e si pasojë për të ndryshuar gjendjen e stabilizuar në vendin tonë, në lidhje me monarko-fashistët grekë dhe reaksionin e jashtëm".
 Ziu thotë se nga shqyrtimi i Dosjes që përmban proces-verbalet e seancave gjyqësore, rezultoi se gjyqi për "sabotazhet e Kënetës së Maliqit" zgjati vetëm 16 ditë dhe u publikuaz gjërësisht në radhët e popullit shqiptar. Sipas pretendencës, nëpërmjet sabotimit me stil të gjërë, në strukturën ekonomike dhe më pas politike të shtetit, synimi final i grupit të inxhinierëve, të cilët i quan reaksionarë ndërkombëtarë, ishte të vendoste në rrezik integritetin e vendit dhe të mashtronte pushtetin dhe popullin. Pjesëtarët kryesorë të grupit martir i inxhinierëve që u akuzuan për sabotim ishin: Abdyl Sharra, Kujtim Beqiri, Vasil Mano, Zyraka Mano, Mirush Përmeti, Paolo Saggiotti, Eugenio Scaturro, Pandeli Zograf, Aleks Vasili, Mihal Stratobërdha, etj. A. Sharra dhe më pas, K. Beqiri ishin drejtuesit e punimeve në Kantierin e Maliqit, siç rezultoi edhe nga relacionet e Sigurimit për zhvillimin e punimeve atje, ndërsa pjesa tjetër shërbenin si punonjës në kantier. Zyraka Mano, e cila ishte një shtetase me origjinë kroate, e martuar me njërin prej inxhinierëve, Vasil Manon, u akuzua si personi që bënte të mundur komunikimin midis H. Fultz dhe grupit të inxhinierëve. sipas Ziut, vendimi i Gjykatës është shumë i shkurtër (vetëm 4 faqe) dhe përsëri aty nuk përmbahen argumente juridike për të mbështetur apo kundërshtuar pretendencën e prokurorit dhe dënimit e dhënë. Nga ana tjetër, mbrojtja e avokatëve mbrojtës është shumë e dobët dhe e shkurtër, ku të pandehurit i kanë pranuar "fajet" dhe tregojnë pendesë të thellë për veprimet e tyre. Në përfundim, dënimi që u dha gjykata shumicës prej të pandehurëve ishte ai i dënimit me vdekje, ku inxhinierët Kujtim Beqiri dhe Abdyl Sharra u dënuan me varje në

litar, ndërsa Zyraka Mano me të shokun me pushkatim.
 Aktualisht nuk rezultoi asnjë provë e drejtpërdrejtë, e shkruar që të mbështesë teorinë se këto rekrutime përfshinë edhe grupin e inxhinierëve të Maliqit. Dënimi i grupit "sabotator" të Kënetës së Maliqit u konsiderua një sukses politik nga ana e Sigurimit të Shtetit, siç rezultoi nga një shkresë adresuar Seksionit të Sigurimit në Korçë nga Ministria e Punëve të Brendshme, vëren Ziu në studim.
 Objektivni kryesor i këtij studimi ka qenë jo vetëm të hedhë dritë mbi një prej rasteve të shumta të shkeljes së të drejtave të njeriut përgjatë periudhës pothuajse 50 vjeçare të sundimit komunist në Shqipëri, por edhe të kontribuojë në edukimin e publikut të gjërë, sidomos atyre që nuk e kanë përjetuar këtë periudhë, në rëndësinë e të njohurit të të kaluarës, në mënyrë që të shihet drejt së ardhmës.
 Pavarësisht faktit se elementë të regjimit komunist shqiptar ndryshonin nga ai në vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore e si i tillë mund të quhej unik, vetëm për Shqipërinë, përsëri mund të nxjerrim mësimet të rëndësishme universale. Mësimi kryesor është se potenciali i tmerrshëm që mund të ketë "demonizimi" i personit për shkak të ideologjisë së urretjes të sanksionuar nga shteti. Ky mësim i përbusjez apo ky proces dehumanizimi (siç ishte lufta e klasave) ishte baza e persekutimit dhe internimit të mijëra personave dhe shkelja sistematike e të drejtave të tyre më thelbësore.
 Ziu shton në fund se Shqipëria ende ndodhet sot relativisht në mes të procesit të demokratizimit të saj, ashtu si në hapat e parë drejt objektivit të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Për këtë arsye, duhet të respektojë dhe inkurajojë angazhimin për të përkujtuar viktimat e regjimit komunist, për të respektuar të mbijetuarit e tij dhe për të riafirmuar aspiratën e përbashkët për solidaritet dhe drejtësi.

Akuzat e paprovuara dhe një letër e Departamentit të Shtetit

FESTIVALI

Sherlok Holmes mbërrin në teatër

Një histori e njohur, në Londrën e viteve 1890, ku flitet për Sherlock Holmes, një detektiv imagjinar i krijuar nga autori britanik Sir Arthur Conan Doyle, e përshtatur për skenë teatri nga dramaturgu Ken Ludvig.

"Sherlok Holmes dhe Langoi i Baskervilleve" është një vepër që bashkon dy zhanre letrare popullore: përrallën gotike dhe trillin e letërsisë detektive. Kjo komedi, e cila do të vihët në skenë në datën 13 dhjetor mban të ngacmuar kureshtjen e publikut për të lidhur fjetet e ngjarjeve dhe shijuar në maksimum procesin e zbulimit. Ndërsa trupa e përbërë nga shtatë aktorë do të sjellin në skenë një mori personazhet. Rozi Kostani interpreton në rolin e Doktorit Watson, ndërsa Gentian Hazizaj në rolin e Sherlok Holmesit ndërkohë aktorët e tjerë Herjon Mustafaraj, Mirela Naska, Amri Hasanbelli, Ermir Hoxhaj, Klodjana Keco, do të sjellin rreth dyzet karaktere mes situatash plot humor.

Shafaqja "Sherlok Holmes dhe Langoi i Baskervilleve" nga Ken Ludvig dhe regji nga Shkëlzen Berisha është premiera e fundit për këtë sezon në Teatrin Metropol.

Regjisori Berisha ka punuar për një spektakël dinamik, me ngjyra, gjallëri, e energji që shpërthen nga ironia e situatave, në të cilat prishmëria dhe realiteti janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Ritmi, ngjyrimi dialektal, puna me gjuhën dhe theksat, harmonia mes fjalëve dhe gjeit tek individit dhe pastaj mes ansambllit kanë qenë sfidat e këtij procesi mjaft të pëlqyeshëm. "Çdo gjetje apo element duhet të bazohet në saktësi dhe harmoni", thotë ai, ndaj procesi ka angazhuar potencialin edhe të njohura edhe të panjohura të aktorëve, për të bërë të pandjeshme ngarkesën dhe arritur një nivel profesional të pëlqyeshëm dhe mikpritës nga publiku", vëren regjisori.

Romani përdor temat dhe simbolat tipike gotike: një mallkim familjar dhe një legjendë për një qen paranormal dhe djallëzor, një hero i bllokuar në një vend të çuditshëm, shkelja e tabuve morale, shqopishtet e zymta që mbajnë sekrete të këqija, hijet e errëta, dhe peizazhe të tmerrshme, të mbuluara nga mjegulla. Sherlock Holmes sulmon legjendën e mallkimit Baskerville me armën e arsyes dhe të meto-



Premiera e "Metropolit", mes përrallës gotike dhe trillit të letërsisë

dave shkencore të vëzhgimit, analizës dhe përfundimit. Megjithatë, kur Sherlock Holmes nuk është në regjim dhe Dr. Watsoni drejton komplotin, elementët gotikë e marrin përsipër rrjedhën e tij.

"Kam qenë i interesuar gjatë procesit", thotë regjisori - që të punoj në disa nivele shprehimore, të cilat në bazë kanë drejtpeshimin. Për të, është parë me vend ndërthimi i formësimit të dialogut të personazheve me një gjuhë të sjell në një freski dhe larmishmëri që të kujton kohët e vjetra dhe i shkon për shtat situatave, me realizimin artistik. "Kombinimi i disa formave teatrorë, të cilat e stërvitin aktorin që të evitojë emocionet përzierë me energji të tepërta, duke synuar përthyerje të shpejta dhe ngacmuese dhe i japin publikut një zinxhir situatash mjaft të gjalla që ndryshojnë dhe transformohen çdo cast".

Skenografia transformohet aty për aty duke mbajtur aktive imagjinatën e publikut gjatë gjithë kohës dhe duke u shërbyer ngjarjeve njëkohësisht, por edhe tensionit të veprimit të personazheve. "Për ta përmblodhur, mund të them se zbulimet e Sherlokut dhe Watsonit, na kanë nxitur një seri zbulimesh të tjera në mënyrën se si kjo shfaqje do të prezantohet para publikut dhe me gjithë lodhjen, jam mjaft i kënaqur për të gjitha eksplorimet e reja që kemi mundur të përfytyrojmë, takojmë dhe realizojmë. Tashmë mbetet shkëmbimi me publikun, që është edhe reflektuesi praktik i gjithë kësaj pune", shton Berisha.

Shafaqja do të jetë në sallën "Shekspir" në Teatrin Metropol në datat 13,14,15,16 Dhjetor, në orën 19:00 dhe do të vazhdojë përsëri në janar e vitit të ri. Shkëlzen Berisha është një aktor dhe

regjisori shqiptar nga Kosova, i cili vjen nga një përvojë 7-vjeçare në Britani si aktor, drejtues dhe praktikues i programeve të Dramës dhe Teatrit. Më pas ka zhvilluar aktivitetin në Kosovë si Drejtor Artistik në Teatrin e Gjilanit dhe më pas në Tiranë, si Drejtor Ekzekutiv i Qendrës së Hulumtimit Progresiv. Aktiviteti i tij shtrihet edhe tek përkthimet dhe dramaturgjinë. Rreth 40 vepër të përkthyer prej tij janë vënë në skenë në teatro në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal i Zi. Në rolet janë: Amri Hasanlliu, Ermir Hoxhaj, Gentian Hazizi, Herion Mustafaraj, Klodjana Keco, Mirela Naska dhe Rozi Kostani.


Kostumografe Jonida Beqo, kostumografe realizuese Suzana Bodinaku, as. regji Rexhina Mollaymeri, skenografia nga Arian Xhao e Griseld Kapllanaj, fragmentet e orkestruara nga Jusiald Xhani.

EKSPOZITA

"N'JERM"

Një arkiv i panjohur dhe i pautorësi

Ekspozitë personale nga Lek M. Gjeloshi në "Zeta"



Çelet këtë të premte në Galerinë "Zeta" ekspozita "N'jerm" e artistit Lek M. Gjeloshi. Ajo paraqet një cikël me fotografi të shkëputura nga një grumbull negativësh me të cilët autori ndeshet rastësisht, nisur si pretext për të testuar me të një makineri të vjetër për zmahdimin e filmave 35mm. Imazhet e seleksionuara përmes saj janë fragmente të organizuara pa një rend të paracaktuar narrativ. I tërhequr nga dimensionit fantazmagorik i subjekteve mbi sipërfaqen e ekranit, ai fillon t'i rifotografojë duke aktivizuar gradualisht një jetë të dyfish-të të imazheve, ku pjesë e tyre është tashmë edhe drita e ekranit të projektorit, gjurmët e vjetërsisë dhe reflektet që ndodhen në sipërfaqen e tij. Këto fotografi i inverton më pas në negativ dixhital duke përdorur opsionin e zakonshëm që ofron aplikacioni i celularit. Nga kjo mbivendosje negativësh, procesi algoritmik i thjeshtë prej ku ai përfton imazhe, "pozitivët" hibrid, të cilat ngarkohen me një atmosferë të re që nuk referon më informacionin e fotografisë e as dëshminë e saj, por devijimin konstant, një soj kllapie ose përcartjeje të asaj që mbetet mbi sipërfaqen e mbështjellë nga tisi i blucianit.

Kështu vjen në dritë një arkiv i panjohur dhe i pautorësi. Në të na shfaqen trupa, rite liturgjike e peizazhe të vagullta, ekzistenca herë të magjepsura, herë të mbetura pezull në një fshat të mistershëm diku në Shqipërinë veriore.

Lek M. GJELOSHI ka lindur në vitin 1987, në Shkodër, ku aktualisht jeton dhe punon. Ai studioi Art Vizual në Akademinë e Arteve të Bukura në Firence, ku u diplomua në vitin 2010. Ekspozitat e tij solo përfshijnë "All My Colours Turn to Clouds", Villa Romana, Firence (2016) dhe "Off-Cells", Galeria e Arteve, Shkodër (2016). Në vitin 2015 ai ishte fitues i Çmimit Idromeno, i dhënë nga Galeria e Arteve të qytetit të Shkodrës. Një vit më pas (2016), ai fitoi Çmimin Ardhje për artistët e rinj vizualë shqiptar. Që nga viti 2017 është përgjegjës i arkivit në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi", në Shkodër. (2018) ka qenë artist në rezidencë në Residency Unlimited, New York. Ai ka marrë pjesë në ekspozita të shumta në grup si: "Ex Gratia", në Koleksionin Iannacone në Milano (2018); "A time for dreams", në Muzeun e Artit Modern të Moskës (2014); "Nuovo Cinema Masaçio" (2014), "Fuori posto" (2013) dhe "Lontano da dove" (2012), në Casa Masaçio dhe në Fondacionin Lanfranco Baldi, në Itali.

Ekspozita mund të vizitohet deri më 10 janar 2019.f.a.ni.

Opinion i Ditës

Studentët plasën, ndaj protestojnë!

Ing. Klaudio Nuredini

Prej disa ditësh vendi është përfshirë në protesta ma sive nga studentët të tejnogopur prej mizorisë që reflekton arsimi shqiptar. Thonë që "peshku qelbet nga koka", por arsimi këtu është një trup i dekompozuar, i keqpërdorur qëllimisht për të prodhuar analfabetë funksionalë. Nuk dua ta nis me pjesën nëse protesta e studentëve është e drejtë, sepse këtë e marr apriori të mirëqenë dhe i bashkohem në çdo thirrje atyre mijëra të rinjve që janë në rrugë jo për qejf, por, sepse u ka ardhur në majë të hundës mënyra si janë trajtuar: si kavje me të cilat mund të eksperimentosh si të duash, kur të duash, në sigurinë se janë të pazotë të kundërpërgjigjen. Studentët po e tregojnë më në fund fuqinë që kanë dhe zëri i tyre duhet të jetë zë revolte i të gjithëve ne.

Studentët shqiptarë mbajnë mbi kurriz pamundësinë e prindërve për t'u siguruar financiarisht një jetë të rehatshme sa kohë janë studentë, mbajnë mbi kurriz pamundësinë e politikave për t'u dhënë vlerë diplomës së tyre, mbajnë peshën e harxhimit të kohës disa vite nëpër auditorë, për të marrë në fund atë copë letër që i degdis rrugëve duke u vrrarë ëndrrat. Mbajnë mbi kurriz edhe përgjegjësinë për të ardhmen, që nuk e kanë në dorë ta ndërtojë vetë (pavarësisht retorikave boshe që artikulojnë politika se të rinjtë janë e ardhmja e vendit). Deri sot që ata e jetësuan këtë përkufizim, studentët trajtoheshin vetëm si grumbuj dembelësh bashkuar kafeneve, të cilëve ju intereson një diplomë, për të marrë më pas rrugët e botës, sepse "ky vend nuk bëhet".

Të rinjtë po dëshmojnë të kundërtën, që ky vend ka nevojë të ngrihet prej gjumit letargjik, të marrë frymë me të dyja mushkëritë dhe të bëhet siç duhet, jo siç ju duhet intereseve partiake. Ata refuzuan t'ju binden "skuthave politike" që vetëm i kanë shkatërruar deri tani, duke ndjekur të vetmin interes që mbizotëron: Të drejtën e shkollimit njësoj si bashkëmoshatarët e tyre kudo në botë, të drejtën për t'u trajtuar me dinjitet dhe të drejtën për të marrë mbrapsht shpërbimin e viteve lodhje. Në këtë mënyrë auditorët morën jetë dhe vlerë!

U desh një rebelim i disa të rinjve që të gjithë ta kuptonim se po na mbyste korrupsioni, varfëria, zhgënjimi, largimi; po na mbyste pamundësia për të folur, për të vepruar; po na lodhte monotonija që prodhohej çdo ditë në këtë vend që nuk tregonte asgjë të re, vetëm përralla të ripërsëritura me të njejtën fabul. U desh guximi i disa të rinjve, që gjithë shoqëria jonë të ndjente turpin e heshtjes dhe kokë uljes. U deshën pak të rinj, që tani të bëhemi të gjithë shqiptarët bashkë, duke refuzuar boshësinë me të cilën politika jonë na ushqen përditë. Unë sot



jam student, sepse jam shqiptar. Dhe ashtu si çdokush tjetër e ndjej të keqen që ka hapur tentakulat në çdo hallkë. Sepse, mos mendoni se ajo është një protestë me 8 pika, është protesta që i vë pikën durimit dhe nxit reflektimin. Është një thirrje energjike për të mos fjetur më, sepse po shtypemi. Është rebelimi i të rinjve për të mos u larguar ata nga ky vend, por për të larguar këdo që i cenon dhe u vë ferra në rrugën e tyre.

Njëra prej tyre, reforma në arsim ishte, në fakt, shkatërrimi i arsimit shqiptar. Një ndërthurje e interesave të ngushtë që e konceptojnë arsimimin si biznes për të bërë para, me një neglizhencë politike që e zhvlerëson diplomën në krahasim me tesaerën e partisë. Arsimi në Shqipëri po diplomon të rinj që u duhet ajo letër, jo për të marrë dije, por për të marrë kartonin që i hap dyert e administratës së shpejt, nipit të deputetit, të paafitit. Këtij soj grupi nuk u intereson arsimi cilësor, u intereson diploma, në mënyrë që të depërtojnë me lehtësi nëpër shpirtin e kalbur të sistemit që është ngritur. Ky sistem e përjashton të afftin, i vë shkopin nën rrota, e denigron dhe varfëron deri në atë

pikë sa të mendojë vetëm për bukëni e gojës, të mos mundet të ngrijë kokë.

Po të shikosh ligjin e nëpunësit civil, është legjitimim i asaj që shkrova më lart. Aty është përcaktuar qartë që nuk bën pjesë në këtë sistem nëse nuk ke disa "kushte" që i kanë përpiluar për fëmijët e tyre, tarafin e tyre, atë që u vjen pas isos etj. Aty nuk kërkohet profesionisti, kërkohet vetëm dikush që plotëson ato "kushte", që nuk tregojnë askund sa dije ka aplikanti. Mjafton Masteri, pa pasur rëndësi si është marrë ajo diplomë, pa i kushtuar rëndësi nëse është e rregullt apo e marrë false, nëse është në përputhje me ushtrimin e profesionit apo jo. Mjafton letra që tundet përpara syve të atij që pretendon meritën! Për pjesën tjetër, që besojnë tek arsimi i vërtetë dhe kërkohen punësimin me ndershmëri, tepsia nuk bën pjesë. Kështu, ata gjejnë zgjidhje të tjera për të mbijetuar: disa emigrojnë, disa kthehen nga juristë në kamerierë, ca të tjerë nëpër call center, disa shitës, një pjesë përfundojnë në depresion. Por sistemi i ngritur, sipërfaqsisht shkëlqen dhe duket në rregull, por përbrenda është i mykur dhe krejtësisht i njëanshëm.

Ndaj kujt protestojnë studentët sot?

Ata protestojnë pikë së pari ndaj këtij sistemi që vetëm i rrjep, duke mos u dhënë asgjë në fund, që u merr e u merr para dhe i dëmshpërblen me një letër për t'i pirë lëngun. Për interesa biznesi dhe favorizim universitetesh private, tarifave e universiteteve shtetërore vetëm po rriten, ndërsa kushtet e zhvillimit të mësimin vetëm degradohen. Duke i lënë auditorët bosh. Pikërisht ashtu si kjo politikë donte t'i shikonte: të boshatisura, me të rinj që ikin drejt universitetesh private dhe arsim publik që shkërmoqet.

Studentët sot protestojnë ndaj kushteve që kanë nëpër auditorë: nuk ka sistem ngrohje, nuk ka shumësia, nuk ka projektorë, nuk ka salla. Pedagogët "zihen" me njëri-tjetrin se kush zaptin i pari një auditor për të bërë mësim, ndërkohë që ka orë të cilat nuk zhvillohen, sepse nuk ka salla të lira. Studentët ngjeshën treshe në banka, sepse aq hapësira ka, nuk ka karrige mjaftueshëm për t'u ulur, ambientet janë të papastra, të rrethuara me hotele dhe kafene. Mungojnë plotësisht bibliotekat, nuk gjen dot literaturën që të nevojitet.

Studentët protestojnë ndaj pedagogëve. Ndaj atyre që korruptohen dhe ngelin studentët, sepse duan para. Që nuk i lënë studentët të hyjnë në provim nëse plotësojnë 25% të mungesave, por ofiqi i tyre ju jep luksin të mungojnë në 75% të orëve mësimore pa i dhënë askujt llogari dhe duke marrë rrogën normalisht. Ndërkohë që, studentët edhe punon, edhe studiojnë për të përballuar jetesën e vesh-tirë që u ofrohet këtu. Protestojnë

ndaj atyre pedagogëve që marrin me listë emrat e studentëve që u kanë blerë librat nëpër bodrumet e fakultetit, ndaj atij pedagogu që përkthen me Google Translate leksione dhe që nuk është as i zoti t'i referojë. Protestojnë ndaj atij pedagogu që ka ardhur aty, sepse ka pasur gjyshin, babain, mamanë, hallën tezen, xhaxhain më parë aty. Ndaj atyre që e kanë kthyer në pushtet të trashëguar universitetin dhe dalin në pension duke vendosur në vendin e tyre fëmijët e tyre.

Studentët protestojnë ndaj tarifave ekstremisht të larta që u duhet të paguajnë. Të rinjtë paguan një miliona lekë për të dalë në një treg shterp pune. Politika tregon se kështu janë në gjithë botën, por gënjejnë! Në asnjë vend të zhvilluar, arsimi publik nuk është më i shtrenjtë edhe se arsimi privat. Në asnjë vend të botës nuk ndodh kështu! Gjermania, Estonia, Danimarka, Finlanda, Norvegjia, Sllovenia janë disa prej vendeve europiane që unë e di me siguri të plotë që arsimin publik e ofrojnë fala! Sepse ata dinë ta trashëgojnë atë që e konsiderojnë një të mirë të përbashkët.

Studentët protestojnë ndaj të keqes që ka hedhur rrënjë në këtë vend, që i jep hapësirë të paafitit dhe mbyti të zotin. Studentët protestojnë ndaj plagjiaturës që ka hedhur rrënjë në gjithë sistemin. Nga "profesorë" që janë profesionistë vetëm në zhatvje, në vjedhje, dhe janë bosh në përmbajtje. Universitetet publike, nga pika e referencës së ekselencës për këtë vend, politika po përpiqet t'i kthejë në mejhane pa vlerë. Po i zhvlerëson në shumë mënyra, hapur apo tërthorazi. "Autonomia e universitetit" nuk është asgjë më shumë veçse përplekë për të gëpusur Universitetin publik dhe për të shpërndarë fonde nëpër furriqet me emrin "universitet" që kanë vetë në pronësi.

Studentët protestojnë, sepse nuk u dëgjojnë kërkesat. Paratë që paguajnë nuk e dinë ku shkojnë, kush i keqmenaxhon, sepse ata nuk ndiejnë asnjë përmirësim, pavarësisht se tarifa rritet çdo vit edhe më shumë. Dhe topi nuk duhet të hidhet sa nga universiteti, tek qeveria. Topi është në fushën e të dy palëve. Sepse bashkërisht fusin duart në paratë e studentit dhe bashkërisht kanë hartuar një mish-mash që hedh në treg robotë të cilët riprodhojnë mekanikisht loqet e tyre.

Qeveria ka në dorë të verë dorë mbi atë pasuri publike që e kemi të trashëguar me dinjitet dhe që të gjithë bashkë po e shohim si degradim, pa bërë zë. Le të fillojë vetingu edhe në arsim!

Kjo protestë nuk është moment shpërthimi, është kohë reflektimi për të shpëtuar atë universitet që ka nxjerrë njerëz të dijes, të cilat na krenojnë nëpër botë. Na duhet të pastrojmë universitetet publike, dhe ky është katarsisi që do e shkulë të qenës, për t'i dhënë një frymë të re arsimit në Shqipëri. Frymën e lirisë dhe të drejtës për të kërkuar dije, jo veç diplomë!

"Fac sapiens liber eris" (Bëhu i ditur që të jesh i lirë) është një thënie e vjetër latine, e cila legjitimim dobinë që vjen nga dija dhe domosdoshmërinë e kombeve për të ndjekur këtë shteg drite që trashëgon nëpër breza pasurinë e mendjes.

Opinioni

i Ditës

Një tjetër ciklon i afrohet uraganit të protestave...!

Nga Ilir Çumani

Një tjetër ciklon i afrohet uraganit të protestave të studentëve... Ajo e sindikatave të hidrokarbureve në lidhje me rritjen e çmimit të naf-tës, e sindikatave të infermierëve për pagat e ulëta dhe kushtet e vështira në sistemin shëndetësor, apo të tjera grupe interesi si minatorët dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët do të reagojnë në ditët në vijim me pakënaqësitë që ata kanë, në përbushje të kërkesave ekonomike dhe të drejtave legjitime të mohuara. Kryeministri Rama i ka dalë situata nga kontrolli. Ai e ka të pamjaftueshme kohën për t'i dhënë zgjidhje gjendjes së krijuar jo vetëm për shkak të arrogancës, mënyrës dhe mendësisë autoritariste të qeverisjes, por edhe për faktin se u gjend në befasi dhe i papërgatitur përballë këtyre zhvillimeve që u shfaqen krejt papritur. Mbrëmë, të gjithë shqiptarët panë dhe ndoqën me zë dhe me figurë, në një prej televizioneve komëbëtare kryeministrin e vendit, të përçartur, të zbehtë, të tensionuar dhe gjysmë i dorëzuar, i cili përpigjej të lektronte "qetësisht" me një retorikë dhe tone të ulura ofertën për kompromis, që nënkuptonte zgjatjen e dorës, sjellje kjo e pazakontë për natyrën e tij. I vënë përballë një auditori me një skenografi dhe pjesëmarrje të përzgjedhur, ai monologonte duke u shfaqur emocional dhe i paduruar, duke ndërprerë shpesh bashkëbiseduesit në studion që vetë i kishte thërritur t'i dëgjonte. Heraherës, tregohet imponues dhe këmbëngulës për të bindur studentët se, në parim ishte dakord me kërkesat e tyre, por që në fakt, ishte i paqartë nëse ato do të mund të konkretizoheshin dhe materializoheshin prej tij apo jo...!? Dhe pikërisht, kjo është arsyeja përse studentët që në fillim të herës janë skeptikë, janë treguar të mençur dhe të kujdesshëm, nuk kanë zgjedhur të identifikohen me një përfaqësi të tyre, por të gjithë së bashku në bllok dhe njëzëri i refuzojnë negociatat me qeverinë dhe nuk pranojnë të bashkëbisedojnë me të. Ata e ndëjnë dhe u druhen manovrave të kalkuluara në perfeksion, lëvizjeve spektakolare të paparashikuara që kryeministri mund të bëjë me ta gjatë këtij procesi "bashkëbisedimi", ndoshta edhe për t'i manipuluar, sepse në fakt, ka precedentë të mëparshëm dhe të njohur në historinë e protestave në Shqipëri. Kështu ka ndodhur në këto 28 vite me të gjitha qeveritë. Nga ana tjetër, vetë studentët janë të vendosur në kërkesat e tyre duke mos i bërë asnjë lëshim qeverisë për të të pikat e panegociueshme që ata kanë



parashuar dhe për këtë, ata deklarojnë se protestat e tyre do të përshkallëzohen, nëse injorohen prej saj. Është pothuajse e njëjta situatë që ndodhi së fundmi në Francë, ku protestuesit nuk pranuan të negocionin dhe as të bashkëbisedonin me presidentin e tyre, Macron. Ky i fundit, i ndodhur përballë një presioni dhe revolte që dita-ditës po merrte përmasa të frikshme, u tërhoq pa kushte, duke i përbushur të gjitha kërkesat e protestuesve. Në një komunikim publik 11-minutësh me popullin francez, Presidenti i Francës, Emanuel Macron, deklaroi anulimin e vendimit për rritjen e tak-sës së karburanteve, që çoi në një valë protestash të përgjakshme në Francë. Ai premtoi rritjen edhe të pagës minimale me 100 euro për vitin 2019 e në vazhdim. Vendimi i tij i fundit, tashmë do t'i kushtojë

Mbrëmë, të gjithë shqiptarët panë dhe ndoqën me zë dhe me figurë, në një prej televizioneve kombëtare kryeministrin e vendit, të përçartur, të zbehtë, të tensionuar dhe gjysmë i dorëzuar, i cili përpigjej të lektronte "qetësisht" me një retorikë dhe tone të ulura ofertën për kompromis, që nënkuptonte zgjatjen e dorës, sjellje kjo e pazakontë për natyrën e tij.

buxhetit të Francës jo pak, por 10 miliardë euro. Në kontrast me homologun francez, zoti Rama, përmes sofizmave të artikuluar bukur dhe me shumë art gojëtarie, ka zgjedhur të luajë kungulleshkën dhe të mos lëvizë nga pozicioni i tij. Në gjithë këto ditë, ai ka pushtuar hapësinë media-

tike prej orësh të tëra, përfshi edhe komunikimin e drejtpërdrejtë publik me protestuesit prej më shumë se 120 minuta nga zyra e tij përmes ERTV, përcjellë në mediat elektronike dhe rrjetin social "Facebook", ku e gjithë retorika që artikulonete silllej në një rreth vicioz, që nuk po i dukej fundi se çfarë donte të thoshte, duke mos i dhënë asnjë zgjidhje adekuate situatës së krijuar. Në fakt, qysh në krye të herës, kryeministri e kishte mundësinë dhe shansin, të gjithë kohën e mjaftueshme për të reflektuar dhe arsyetuar në këto vite të drejtimit të vendit, për të dëgjuar, konsultuar, vlerësuar e dialoguar me qetësi dhe seriozisht jo vetëm për hallet dhe shqetësimet e studentëve, por edhe për të konsideruar zërin qytetar, atë të grupeve të tjera interesi për të gjitha problemet dhe

shqetësimet që ata kanë. Të qeverisë me arrogancë e mendjemadhësi, duke shpërfillur dhe injoruar me cinizëm interesin publik (që është një atribut ekskluziv i sovranit që të ka zgjedhur), është një shaka që nuk mund të përtypet lehtë, është një lojë e rrezikshme për çdo pushtetar që kthehet në sundimtar autokrat, i cili në verbërinë e tij të gjithëpushtetshëm, mendon se ka fuqinë e demonit dhe e ndjen veten Zot dhe i paprekshëm...! Protesta e studentëve në vetvete nuk është vetëm një revoltë e pakënaqësisë dhe e kushteve të vështira ekonomike që ata kanë, e jetesës mizerabël nëpër konvikte, e tarifave të larta të shkollimit të tyre, e korrupsionit të bordeve dhe senateve dhe e mit-marrjes në universitete. Është shumë më tepër se kaq! Është protesta e lakut të varfërisë që qeveria ia ka hedhur në qafë popullit, duke e rrëjuar deri në qindarkat e fundit. Është protesta e prindërve, baballarëve dhe nënave, e gjysheve dhe gjyshërve, e motrave dhe vëllezërve të tyre, e çenimit flagrant të lirive dhe të drejtave themelore që u janë shkelur e nëpërkëmbur hapur qytetarëve të këtij vendi, për një jetë të dinjtetshme, për të cilat, fatkeqësisht nuk ka qenë e mundur të dëgjohej klithma e vuajtjes dhe zëri i tyre i protestës së përditshme, prej verbërisë dhe shurdhërisë, arrogancës së pushtetit të një qeverie luksokrate e kaktivokrate. Kjo që po ndodh sot është protesta më e pastër dhe më e vërtetë e një gjenerate të re, që i përket të ardhmes evropiane, kundër të shkuarës dhe të tashmës nepotike dhe jo meritokrate, kundër një sistemi shoqëror pa sistem vlerash, e vjetruar dhe e kalbëzuar prej kimit dhe korrupsionit politik dhe administrativ. Studentët sot janë grupimi më i madh komunitar që gëzojnë simpatinë dhe respektin e të gjitha shtresave të shoqërisë, ngase ata janë të pastër si kristali, janë të zhveshur nga të gjitha interesat e ngushta, prej kompleksëve të inferioritetit, hipokrizisë dhe meskinitetit që i prodhon një shoqëri e denaturuar dhe e degraduar nga një politikë e bërë pis dhe e korruptuar. Ndalj, të dashur studentë, sot, të gjithë ju keni marrë një barrë të madhe mbi supet tuaja, keni nisur në udhë të re, drejt një destinacioni pa kthim. Mos lejoni të përdoren politikisht, shtrëngoni fort njëri-tjetrin dhe çojeni deri në fund kauzën tuaj të drejtë. Askush nuk do të ketë fuqinë ta zhbëjë atë që sapo keni nisur. Askush nuk do të mund të shuajë dritën e shpresës së madhe, që do të ndriçojë mendjen dhe të ardhmen tuaj të sigurt, gjithmonë nëse ju do të rezistoni deri në fund të vendosur! Zoti e bekoftë rininë shqiptare!

Kryeministri Rama i ka dalë situata nga kontrolli. Ai e ka të pamjaftueshme kohën për t'i dhënë zgjidhje gjendjes së krijuar jo vetëm për shkak të arrogancës, mënyrës dhe mendësisë autoritariste të qeverisjes, por edhe për faktin se u gjend në befasi dhe i papërgatitur përballë këtyre zhvillimeve që u shfaqen krejt papritur.

Dekalogu i një studenti

Një kryengritje morale

Nga Atjon Zhiti

(vijon nga faqja 1)

... që dua(m), që realiteti i bën prapë aktuale.

Ashtu siç thotë edhe antropologu italian, prof. Mauro Geraci, "Në shkrimet e Atjonit ka filozofi, jo si diçka abstrakte, por të lidhur me politikën, jo në kuptimin e politikës sot, por si të grekërit e lashtë, pjesë e jetës, ndërkaq të lidhura me katalite-tin".

T'i njohim studentët se na njohin, t'i duam studentët se na duan dhe jo vetëm të na dëgjojnë, por dhe t'i dëgjojmë...

DEKALOGU

1 - Liria e vendit tim është e para dhe më e çmuara. Po a jemi gati për atë që duam?


Vendi ynë që nga rënia e perandorisë romake perëndimore, e cila ndërtoi teatro, anfiteatro, rrugë, tempuj e shkolla, ku kanë studiuar "ars militaris" emra si Cezari e Augusti, vazhdon deri më sot të jetë preh e depredimeve të barbarëve, preh e nepotizmit, preh e korrupsionit, preh e inkompetencës së burokracisë dhe administratës, është dhe preh e një demokracie fiktive, shpesh të munguar.

2 - Fasada është e bukur plot shpresë, rrënjët janë të njëjtat, të kalburat...

Shtetari pa shtetasin është një hiç.

2 - Në një regjim gati tiranik nuk është tiranik vetëm ai që është në krye të shtetit.

Tiranian nuk është asgjë tjetër veçse një shtet i servilizmit absolut, jo vetëm servilizëm i qytetarit ndaj detektorëve të fuqisë e pasurisë, por është një servilizëm total, servilizëm i arsyes ndaj instinktit dhe ky servilizëm i jash-



tëm nuk është asgjë tjetër veçse një shprehje e servilizmit të brendshëm.

3 - Lideri ka prirje që nën ndikimin e mediatizimit, të bjerë në narcizëm, pra t'i pëlqejë vetja dhe mendimet e tij në mënyrë të atillë që të mos pranojë asnjë dia-

log me të tjerët, të mos pranojë gabime, të mos tregojë kufijtë e dijes së vet, përballë së cilës nis injoranca e tij.

A nuk mendoni se ky pohim u përshtatet drejtuesve tanë, kur flasin... për ato që vetë nuk i bëjnë dhe nuk flasin për ato që bëjnë?

4 - Korrupsioni është një krim ndaj kolektivitetit, një plagë ndaj të mirave të saj materiale dhe jo. Gjithsesi. Jepet rasti që shoqëria jonë që prej hapjes së tregut të lirë është kthyer në një konglomerat privatësh dhe partikolarësh, ku pasioni civil nuk ka zënë rrënjë. Kuptohet që në këtë habitat korrupsioni është i toleruar, bile i mirëparë edhe nga kush nuk ka asgjë tjetër në dorë përveçse të humbasë.

...Korrupsioni rrjedh nga fort-e-dashura shoqëria civile: që ka pushtuar botën e sipërmarrjes, të kreditit dhe të informacionit, ka kalbur privatini gati po aq sa gjënë publike. Dhe vatra e problemit është politika, sepse e tillë është bërë veshja, por prapë nga vatra mund të vijë ndryshimi, në këtë rreth ku i përbashkët është fillimi dhe fundi.

5 - Për "Opinionin". Sot në shoqërinë tonë, tërë jeta e shoqërive, ku mbretërojnë kushtet moderne të prodhimit, prezantohet si një akumulim i madh spektaklesh. Spektakli nuk është më një bashkësi imazhesh, por një raport social që ka imazhin si medium. Realiteti kështu lindte spektaklin dhe spektakli bëhet real. Imazhi është mall dhe malli kështu ngarkohet me imazhe, imazhe spektakolare, të cilat e mbushin mallin plot jetë dhe çojnë konsumatorin e pamundur për shumë në iluzion. Ky mall i kthyer kështu nuk e ka çliruar njeriun nga nevoja, por i ka ushtruar një presion të ri, një kusht të ri, konsumizmin. Në sajë të kthimit të mallit në parësi, malli ngarkohet me alegori e kuptim simbolik. Malli konsumohet me dukjen, nuk duhet më për mbijetesën dhe kështu pra kemi një mbijetesë të mbingarkuar. Akoma më e shterpët se nevoja e mbijetesës. Në shoqërinë tonë është dramatike se si të qenit, zëvendë-

sohet nga dukja.

6 - ... Ndje një antipati për shkollën. Më duken orë të humbura. Mos ma përmend fjalën shkollë. E urrej shkollën dhe librat që na jep për të lexuar... Shkolla ime nuk më stimulon, nuk më mëson gjë të re, nuk mendon në nivelin tim, më fal(ni) për modestinë...

...Të bësh mirë ti e di ç'a dmtth., nuk flitet vetëm për nota e sjellje. Flitet për pasion, dëshirë, këmbëngulje, sakrificë ndoshta edhe vuajtje, por pasioni është kryesori.

7 - Por, ajo çka do të ishte më e dhimbshme, do të ishte nëse shqiptari nuk do të bënte asgjë për të ndryshuar. Duket sikur premtimi i pambajtur e abuzimi i vazhdimtë ndër vite ndaj vetes dhe vendit, i pozitës janë kthyer në rutinë dhe ajo çka është fatale është fakti se si mirësia e integriteti intelektual të duken si risi...

8 - Kur padrejtësia e përgjithshme bëhet rrugë, rezistenca është detyrë.

Ne i futemi thellë të vërtetës. Sa thjeshtë e zhveshim atë. Preferojmë sinousitetin e elegancën ndaj mbulesës, por në fund del që lëkura lakuriq është më e komplikuar se mbulesa dhe fundi pastaj bëhet i thjeshtë... Por rruga është keq. Ka shumë gropa. Kërkimi është zhveshje.

9 - Duhet të ndërgjegjësohemi e së bashku, duhet të bëjmë një kryengritje morale, të vazhdimtë...

Duhen pasur si burim force e njëkohësisht "thembër Akili" vlerat e paqes e të kulturës, mbrojtjen e të drejtave civile e të lirisë dhe mbi të gjitha një shoqëri më e përbashkuar, pa harruar një patriotizëm erudit e jo një nacionalizëm të shterpët që kemi adoptuar dekadat e fundit, tipik i popujve të vegjël.

10 - Të bësh të kthehen gjërat në shërbim të lumturisë së njeriut.

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

GAZETA SHQIPTARE

Opinion *i* Ditës

Dialogu i dajakut verbal

Elsa Skënderi - Rakiplari
(pedagoge)

(vijon nga faqja 1)

... pas here iu hakërrehj "Po si ke ardh' ti këtu? Kush të ka sjellë ty këtu?". Ndërkaq, në "Facebook", ku bashkë me lajme të rreme, shpesh gjëllinjë dhe ca të vërteta, njerëzit kishin gjetur se kush ishte in ata që po dialogonin, duke ripërtypur ç'u kishte dhënë për të ngrënë spin doctor-i i kryeministrit. Studentët dialoguesin u dukën si buratinë (të këtyllë fatkeqësisht ka e përdor çdo grupim partiak ose politik) që i kishin vënë të luani rolin e të indinjuarve, të cilët kanë sot tetë ditë që protestojnë. Dialoguesit e gjorë duhej të aktronin e të duronin edhe sulme verbale të tipit: "Po pse i perëndon sytë ashtu? Pse i perëndon sytë sa herë që flas?". Megjithëse ishte me benjaminet e tij, si në rastin e monologut fejsbukian, kryeministri e humbi toruan. Bërtiti, gëlthiti, u hakërrye. Ai që mburret për forcën e fjalës së kultivuar, dhe shtrëngoi dhembë e nofulla për çdo dorashkë sfide që i hidhnin "të revoltuarit" e atyshëm.

Me tone paternaliste, studentëve që në fillim i etiketoi si ngrëlës, kryeqeveritari u tha të mos shqetësoheshin. Ai ishte me ta! Nuk kishte për t'i lënë në baltë! Por ftesa për besim e dialog u shkërmoq e gjitha nga dështimi i skenarit alla "One man show". Llogjet dialogjike televizive, pantonimat nervoze, përplasjet ideore me zë të lartë nuk kanë zgjidhur dot kurrë ndonjë problem.

Kryeministri, siç e ka pranuar edhe vetë, është i këtyllë, s'ka ç'të bëjë. I bie të vithiset herë pas here në vorbullën e arrogancës e hakërrimit, veçanërisht nëse të tjerët nuk pajtohen me të. Për fat të keq, arroganca është filli i diskutimit që i lidh bashkë takimet e bashkëqeverisjes, ku fyhen burra e gra pse nuk "bashkëqeverisin" me të gati tu!, qëndrimet ndaj protestuesve "barbarë, vandalë, shpellarë", përgjigjet ndaj gazetarëve që qeshen e përqeshen se rrojnë jo në ndonjë rreth të gjerë rraj, por në kazan, qëndrimin ndaj të rinjve e studentëve, që janë higjiena e njëmendtë e botës universitare dhe e shoqërisë sonë.

Kryeministri mbrëmë e tetë ditë të shkuara, bashkë me të edhe politika, duhet ta kuptojnë një herë e mirë se ky i sotmi nuk është brezi i hartimeve, por brezi i eseve, ku studentët, megjithëse zëmarrë, t'i shtrajnë argumentet duke të parë në sy e t'i hedhin tutje premtimet e zbërdhlylëta. Ftesa për dialog duket si përpjekje për ta mbajtur edhe më tej të gjithë problematikën në rrafsh verbal. "Ta flasim njëherë" është sfida e qeverisë. Vetë strategjia e komunikimit publik të saj është ngritur mbi idhulltarinë e "Facebook"-ut. Buçkanët e partisë kanë marrë në vëmendje edhe gjatë këtyre ditëve udhëzimet e sakta sesi duhet komentuar gjatë dialogut paternalist të kryeminis-



trit. Inskenimi e ka neveritur opinionin publik, që natyrshëm ngre pyetjen kështu inskenohen të gjitha nismat e reformat qeveritare? Kaq e pacipë dhe e errët është demagogjia?

Një student në mënyrë origjinale ftesën për dialog e konsideroi si ftesë për të negociuar dajakun, mospërkrahjen dhe mungesën e vazhdueshme të vëmendjes së qeverive ndaj studentëve, rrjedhimisht shpërfilljen ndaj universitetit e problematikave të tij. Dje dialogu i kryeministrit me të vetët që një ndër shfaqjet e dajakut verbal ndaj studentëve. Cili kryeministër i botës moderne, pavarësisht nëse mburret se dikton modën e

fundit të veshjes, e ka luksin t'u drejtohet qytetarëve me atë ton ankthdijellës e intimidues, që studentët nuk do ta pranin assesi as nga pedagogu më pedant e as nga prindi më kontrollues. Dialogu ankthioz, fjalimet 27-faqëshe, deklaratat e rrudhura në "Twitter" nuk mjaftojnë për t'ua servirur studentëve si të dialogueshme pikat konkrete, teksa ata presin zgjidhje. Ka ardhur tashmë koha që politika të pranojë se universiteti nuk është thjesht institucioni vasal, ku politikanë, funksionarë apo "të intelektualizuar" zgjedhin të ndreqin imazhin duke u bërë pjesë e tij e duke i përveshur mëngët për mësimdhënie. Univer-

sitetit i duhet financim dhe autonomi, jo për të ngopur orekset e drejtuesve të tij, por për t'u rikthyer dinjitetin e bjerrë studentëve dhe pedagogëve, të cilët duan s'duan qeveritë, janë një!

Studentët tanë kërkojnë reduktim të tarifave, përmirësim të kushteve të konvikteve, verifikim të figurave të pedagogëve, biblioteka të pasura, një universitet të denjë! Kanë të gjithë të drejtën e botës për përgjigje konkrete, jo kinse dialogë të inskenuar apo kokëfortësi me vijë masash "O bashkë me mua, o hiç!". Nëse punët që duhen bërë qenkan, e në fakt janë kaq të shumta, le t'i bëjnë pa rrahur gjoks, pa stilema e filozofema populiste. Me sezonin e provimeve jo fort larg e festat e fundvitit më afër, studentët gëzojnë të drejtën të dëgohen e të marrin zgjidhje për gjithë ç'kanë ngritur, të kthehen në auditorë të fakulteteve, ku të ketë ngrohje e të mos u duhet të ngrënë në krahë karrige nga njëra sallë të tjetra. Studentëve nuk iu lipset një rrahje shpatullash sa për t'i përcjellë, as fjalë në ajër, por zgjidhje konkrete. Shqipërisë, veç zërit të papërllyer të të rinjve, i duhet fort po ashtu, një politikë e qeveri që pasi të ketë bërë as më pak as më shumë se ç'i takon: pasi të ketë mirëqeverisur, të dijë të shijojë edhe krenarinë e heshtjes.

Kryeministri mbrëmë e tetë ditë të shkuara, bashkë me të edhe politika, duhet ta kuptojnë një herë e mirë se ky i sotmi nuk është brezi i hartimeve, por brezi i eseve, ku studentët, megjithëse zëmarrë, t'i shtrajnë argumentet duke të parë në sy e t'i hedhin tutje premtimet e zbërdhlylëta. Ftesa për dialog duket si përpjekje për ta mbajtur edhe më tej të gjithë problematikën në rrafsh verbal. "Ta flasim njëherë" është sfida e qeverisë.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do të mund të arrini të sqaroni një herë e mirë disa mosmarrëveshje në raport me dikë. Sot në aspektin krijues do të jeni në një ditë të mirë. Sa i përket çështjeve financiare, gjërat duken stabil.

DEMI

Tregoni më shumë kujdes për gjendjen shëndetësore. Pak nervozizëm dhe mërzitje do të spikasën në ditën e sotme duke sjellë një sërë detyrimesh të papritura dhe shpënzimesh të kota.

BINJAKET

Nga ana financiare ashtu si edhe nga ana sentimentale gjithçka do të shkojë mirë. Vendosja e planetëve ju bën më të qetë e si rezultat arrini që mendoni në mënyrë më të kthjellët.

GAFORJA

Dita e sotme edhe pse në përgjithësi do të duket e qetë, do të ketë momente tensioni. Përpiguni që ta kaloni pasditen në shoqërinë e një personi, i cili përgjithësisht sjell energji pozitive tek ju.

LUANI

Parashikohet një ditë me fat për të lindurit në shenjin tuaj. Gjërat mund të shkojnë mirë në aspektin ekonomik ku parashikohet të merrni frytet e investimeve tuaja. Edhe situata romantike duket e shëndetshme.

VIRGJERESHA

Nuk do t'ju mungojë dëshira për të çuar përpara disa projekte të lëna në mes. Nëse ekziston vullneti atëherë gjithçka do të mund të realizohet. Edhe në fushën e ndjenjave do të keni fat.

PESHORJA

Mos hezitoni të pyesni nëse nuk keni informacion mbi diçka. Me ndihmën e të tjerëve do të arrini të keni sukses në aspektin profesional. Një rritje pagese ose një shpërbim duket shumë afër.

AKREPI

Do të jeni mjaft tërheqës dhe joshës në sytë e partnerit tuaj falë rreshtimit të planeve që ju sjellin fat. Për pasojë do të arrini që të zgjidhni edhe disa mosmarrëveshje, të cilat ju kishin stresuar.

SHIGJETARI

Parashikohet të jetë një ditë e ngarkuar me punë, por kjo gjë nuk ju bezdis. Ritimi është diçka që ju pëlqen. Një udhëtim i shkurtër do t'ju vlejë shumë për punën tuaj në të ardhmen e afërt.

BRICJAPI

Ditë me fat për të pasur sukses në aspektin profesional. Në çështjet e dashurisë keni nevojë për më shumë energji pozitive. Kohët e fundit keni ndjere nevojën e një personi në krahun tuaj.

UJORI

Situata ekonomike nuk është në moment më të mirë. Në dashuri do t'ju karakterizojë një entuziazëm dhe një dëshirë për të ndërmarrë gjëra dhe vendime të rëndësishme. Është kjo fryma e duhur për të ecur përpara.

PESHQIT

Po kaloni një fazë pak të vështirë shpirtërore, por yjet parashikojnë një periudhë me fat si në dashuri ashtu edhe në punë. Disa pengesa do t'i kaloni me sukses falë mbështetjes së një mikut të mirë.

Ish-mbrojtësi i kuq i Kukësit

Cuculi: E veçantë ndaj Partizanit, por dua fitoren

Qëndroi te Partizani vetëm një sezon, por aq mjaftoi për të bërë për vete zemrat e tifozëve të kuq. Ardian Cuculi do ta përjetojë në mënyrë të veçantë përballjen me ish-skuadrën e tij, pavarësisht se detyra ia kërkon të mos shpërgëndrohet për ta ndihmuar Kukësin të shkojë te fi-



torja. Në një prononcim për "Supersport", 31-vjeçari nuk e konsideron barazimin një hap negativ. "Te Partizani kam kaluar një sezon mjaft të mirë, por tashmë jam futbollist i Kukësit dhe mendoj për

skuadrën aktuale. Do të jetë një sfidë mjaft e vështirë, ku edhe një pikë do të ishte shumë e rëndësishme", deklaroi mbrojtësi i verilindorëve". Pavarësisht se duket si një sfidë vendimtare për Kukësin,

Cuculi nuk i shton dozat e presionit mbi ekipin e tij dhe sipas qendërmbrojtësit, ndeshjet e shumta që ka deri në fund e lartojnë fjalën "përcaktuese" nga ky takim. "Do të jetë ndeshje e rëndësishme,

pasi ata janë në krye, por nuk është vendimtare për titullin, pasi ka mbetur më shumë se gjysma e kampionatit për t'u luajtur, ndaj mund të rikuperohem", tha Cuculi. Një dëmtim në kavigje e ka detyruar të përçatitet veçmas grupit, megjithatë Cuculi duket se do të shtrëngojë dhëmbët për të qenë i pranishëm kundër ish-ekipit të tij.

Trajneri i të kuqve, kundër Disiplinës: Stadium bosh, do dëgjojmë njëri-tjetrin

Gega: Rëndon mungesa e Asanit, por jemi gati për Kukësin

Timonieri është në prag të rinovimit me Partizanin



Jeton Selimi

Partizani luan një ndeshje që vlen sa gjysma e titullit kampion këtë të premte. Kryeqytetasit do të presin në shtëpi Kukësin në kryesfidën e javës së 17-të, ndaj në ambientin e kuq janë duke pritur me mjaft interes. Një fitore ndaj nënkampionëve do t'i lëshonte edhe më të kuqtë drejt titullit të shumëdërruar, ndaj edhe Skënder Gega kërkon suksesin pas barazimit ndaj Teutës.

Cilat janë shenjat që ka lënë në skuadër ndeshja me Teutën?

Ka lënë shenjë të mirë, sidomos nga ana e Durrësit, ka bërë ndeshje të mirë. Kishim shkuar për fitore, por ndeshja tregoi që kemi luhate. Jam i kënaqur që pas atyre gabimeve, ekipi tregoi karakter dhe shkoi aty ku është.

Sa ndikon mungesa e Asanit ndaj Kukësit?

Çdo mungesë rëndon. Asani është moshë e re, por këtë vit është në rrugën e duhur. Nuk është perfekt, por askush nuk është. Deri tani ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm.

Më i vështirë Kukësi apo Teuta?

Teuta u mbyll, kemi luajtur 2 herë, kemi marrë 4 pikë. Tashmë më intereson vetëm Kukësi.

Kukësi është në formë të mirë...



Edi që është një ekip i vështirë, ka potencial, i respektuim. Ne jemi ekipi kryesues me 5 pikë diferencë. Do të bëjmë atë që dimë më mirë. Jemi përgatitur për Kukësin dhe çdo ekip në Shqipëri.

Do t'u kënaqte barazimi me Kukësin, duke qenë se ndodheni në pozita të mira në klasifikim?

S'e përcaktojmë në këtë. Si trajner nuk them se do të hymë për barazim. Do të jemi të kujdesshëm dhe të luftojmë për gjithçka. Barazimi dhe fitorja nuk vendosen në konferencë për shtyp.

Rinovimi?

Jam në shtëpinë time. Marrëveshja jonë ka qenë marrëveshje mes familjesh. Kur erdha, nuk erdha për të

ndenjtur as 5 vjet, as shumë vite, por për të kontribuar. Deri tani jam i kënaqur dhe jam krenar për futbollistët dhe punën që bëj. Kur të vijë momenti, do të diskutojmë.

Merkato?

Kur të vijë e momenti. Kukësi dhe Luftëtari janë ndeshje të rëndësishme. Nuk është dëshira për të lar-

SUPERLIGA		
TE PREMTEN		
Partizani - Kukësi		18:00
TE SHUTUNEN		
Laçi - Tirana	14:00	
Flamurtari - Kamza		17:00
TE DIELEN		
Kastrioti - Teuta	14:00	
Skënderbeu - Luftëtari		17:00
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	16	35
Skënderbeu	16	30
Kukësi	16	30
Teuta	16	29
Laçi	16	26
Flamurtari	16	25
Tirana	16	14
Luftëtari	16	13
Kamza	16	12
Kastrioti	16	10

si, është e rëndësishme që klubi ndodhet në dispozicion dhe nuk do të kursehet. **Dervishi është shprehur se Gega është me fat që ka atë grup...**

E kam pasur Partizanin përpara Dervishit. Kam filluar që në 1983-shin. Secili e di pozicionin e vet. Jam trajner i Partizanit, e vlerësoj kontributin dhe e ndaj me të gjithë. Është mendimi i tij dhe them se është pozitiv.

Diskutuat me Hilën pas ndeshjes me Teutën për përplasjen me Osmanin?

Ka shumë biseda gjatë ndeshjes. Hila është lojtar i mirë, me ego dhe do këtë fanellë. Është i ndërgjegjshëm për vepërimet. Nuk kam dëshirë të kthehem mbrapsht. Nuk kemi asnjë lajm nga Disiplina ende. Nuk jam i interesuar personalisht, ka njerëz në klub që interesohen për këtë. Unë e kam plan.

Mungesa e tifozëve?

Do të jetë ndeshje e qetë. Do të dëgjohej të folurat e trajnerëve. Secili të marrë atë që i takon.

Është momenti që Partizani të kërkojë në federatë që të mos ketë më dënime kolektive?

Në asnjë lloj mënyrë nuk kam dëshirë t'i paragjykoj vendimet. Është fakt që pasnesër nuk do t'i kemi. Për ne është humbje e madhe. Duhet t'u japim komplimentet edhe për në Durrës, që nuk pushuan për 90 minuta edhe në atë kohë.

U ecën me personat që keni në krah në intervistë...

Kë kam në krah na sjell fitoren, nuk është e thënë. Kemi rastisur që edhe kemi humbur. Hebjaj është vetëm 20 vjeç, është profesionist dhe ka dëshirë. Të gjithë presim të shkojë sa më lart.

LIGA E KAMPIONEVE

Big"-ët e katër grupeve të dyta kanë dhuruar performanca në nivelin e tyre, duke sjellë humbje befasuese, ndonëse këto rezultate nuk ndikojnë aspak në kalimin e turit për në fazën tjetër: Juventusit dhe Manchester Junajtidit janë mposhtur me të njëjtin rezultat 2-1, respektivisht nga Jang Bojs e Valencia në fushën e këtyre të fundit, por si bardhezinjtë, ashtu dhe "djajtë e kuq", kalojnë më tej si forcë e parë dhe e dytë e grupit. Ndeshjet e



fundit të Grupit G në Champions League kanë qenë shumë surprizuese, me dy skuadrat e vogla të këtij grupi, që kanë mposhtur dy ekipet e vendit të parë. Me kual-


Të mëdhatë, humbje të padëmshme

ifikimin në xhep, Roma dhe Realit thjesht u paraqitën në këto ndeshje, duke mos harruar energji dhe CSKA dhe Pëlzen përfituan. Madriënët pësuan një humbje të thellë 0-3 në "Bernabeu", me CSKA-në që bëri gjithçka mirë dhe mori tri pikët, por që nuk i mjaftuan për të arritur "Europa League". Kjo për shkak se Pëlzeni mposhti Romën në shtëpi dhe falë përplasjeve

direkte kundër CSKA-së, arriti të ruajë vendin e tretë. Realit nuk kështu vendin e parë në grup, ndërsa Roma mjaftohet me pozitën e dytë. Siti mposht Hofenheimin dhe së bashku me Lionin do të vijojnë më tej në fazën eliminim, sikundër dhe Ajaksi me Bajernin, që u ndanë në një barazim spektakolar 3-3 në sfidën mes tyre.

CHAMPIONS LEAGUE	
NDESHJET E FUNDIT	
TE MARTEN	
Grupi A	
Brynzi - Atletico Madrid	0-0
Monako - Borussia Dortmund	0-2
Grupi B	
Barcelona - Tottenham	1-1
Inter - PSV Eindhoven	1-1
Grupi C	
Cvrena Zvezda - PSG	1-0
Liverpul - Napoli	1-4
Grupi D	
Gallatasaraji - Porto	2-3
Shalke - Lokomotiv Moskë	1-0
TE MERKUREN	
Grupi E	
Ajaksi - Bajern Mynih	3-3
Benfika - AER Athinë	1-0
Grupi F	
Man. Siti - Hofenheim	2-1
Shakhtar Donjeck - Lions	1-1
Grupi G	
Real Madrid - CSKA Moskë	0-3
Viktoria Plzen - Roma	2-1
Grupi H	
Valencia - Man. Junajtid	2-1
Jang Bojs - Juventus	2-1

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ferguson trainer.
6. Grand Prix
8. Eshhtë stacion beduinësh.
11. Një artikull jo për vegetarian.
12. Kujt i vjen... di të bëjë.
14. Kaçaturian kompozitor
16. Logot pa kujtj
17. Parashites për vetë.
19. Aktorja protagoniste e Vertigo.
21. Ndezur në aparaturë.
23. Eshhtë si telefilm.
24. Ai i shtatë është kinemaja.
26. Eshhtë me shumë se kërkesë.
28. Cristiano bomber te Real Madrid.
29. Teket e grave.
31. Në krye të masave.
32. Shkon goja... nga nepsi.
33. Duken të gjata ato të prijtes.
35. Gjysmë batak.

36. Eshhtë për medaljen e parë
37. Eshhtë kujdesi i babait.
- 39.... Maiden që këndojnë.
41. Një "bombë" tenistike.
42. Fillojnë mykjen
43. Janë këngëtarët si Jose Carreras
45. Eshhtë këngë e kënduar nga komiku
47. Lumë në Francë.
48. Piktori i Ura e Narnit.
49. Kapen në kujtj

VERTIKAL

1. Në hyrje të ambientit
2. Neeson aktor.
3. Ente Sociale Rumune.
4. Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
5. Kufizojnë stacionin.
6. Tremb fëmijët.
7. Jepet për t'u marrë.
8. Ypet japonez.
9. Eshhtë pemë
10. Janë tallësit.
13. Roberto trainer italian.
15. Freni këngëtare lirike.
18. Gjysmë totale.
20. Një si divan.
22. Tipare pa zë
23. Ulet në dhomën e lartë.
25. Moore aktor.
27. Qe bomber brazilian.
30. Ishte shpërthimi i Little Boy.
33. Carolina, e bukura e Belle epoqe.
34. Mbarojnë fare
35. Pullman aktor.
37. Eshhtë thëllimi
38. Meg aktore.
40. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
41. Një lidhëz.
44. Kaluar në krye.
46. Fundi i Turandot.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Mund të hidhet te kiromanti
5. Teket e kafes.
8. D'stria e Helena Gjikhës
12. Smith fillozof.
13. Kuke regjisor
14. Një pjesë e minoritetit.
15. Moduli i Neil Armstrong.
16. Mund të jenë gjiqje.
18. Piktori i Ura e Narnit.
19. Markë pistolete.
20. Mbyllli fushatat.
21. Eshhtë dorëzim.
22. Eshhtë detar.
23. Fillojë ilustrimet.
24. Eshhtë hon.
25. Diftong në duel
27. Një pjesë e rifillimit.
28. Një që kuron karien.
31. Nganjëherë duhen vënë mbi.
33. E egër dhe e fortë.

VERTIKAL


34. Janë thënie e famshme.
 35. Janë trupa qellore të tillë.
 37. Iniciallet e Stone regjisor
 38. Memoria në computer
 40. Në krye të trupave.
 41. Mund të jenë diskografike.
 44. Eshhtë e zakonshme për pushime
 46. Skuadër greke.
 47. Bel i Maupassant.
 48. Eshhtë thesar.
1. E famshme ajo maqedonase.
 2. Një zakon.
 3. Bëjnë alarm me ar
 4. Iniciallet e Mallë regjisor
 5. Mund të jetë telefonike
 6. Ka dy faqe
 7. Mund të jetë një cutter.
 9. Në mes të dhomës.
 10. Mbahet me bateri.
 11. Përfshijnë edhe Haitin.
 13. Denis i enëve me presion.
 16. Paguhen për shërbime.
 17. Janë ufo.
 18. Ekstremit në tunel.
 21. Një atentator vetëvrasës.
 22. Markë cigaresh.
 26. Arrihet duke mundur.
 28. Jonathan, regjisor i Heshnja e qengjave.
 29. Eshhtë aparati me zorrë.
 30. Pak servilizëm.
 31. Kështu e ka syrin vigjilenti.
 32. Fatih trainer turk.
 34. ... Nostra me mafiozët.
 36. Mbyllin punimet.
 39. Ai i shenjtë është papa.
 42. Kufizojnë në teknik.
 43. Fillojnë panikun.
 44. Fund tuneli.
 45. Në krye të armatës.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

3			4					7	
				1		5		9	6
				9		7	8		
				5		4	1		8
							2	4	
2		7						1	
4				9				3	1
						4			
6	8	1	3						4

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	5	1	6	7	2	4	8	9
6	9	7	4	8	3	5	1	2
2	4	8	9	5	1	6	3	7
8	1	6	7	2	5	9	4	3
9	2	4	1	3	6	7	5	8
5	7	3	8	9	4	1	2	6
4	6	9	2	1	8	3	7	5
1	3	2	5	6	7	8	9	4
7	8	5	3	4	9	2	6	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

-Vetëm heshnja është gjë e këndshme. Gjithcka tjetër është dobës.

-Eshhtë shumë më e dobishme për shpirtin tuaj të përgjigjenit të mësoni nga njerëzit, të ngritur dhe inferior, se sa të komentoni mbi dobësitë e tyre.

-Askush nuk është i përsosur dhe të gjithë kanë diçka për të ofruar.

-Më e keqja që mund t'u ndodhë njeriut është të evitohet të menduarit.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	9	3		11		5	9	6	11	1	4	3	T	R	I	M	S	M	M	A	S	A	T		
12	16	15	17	6	11		15		4		12	2	A	R	B	E	E	M	L	I	M	A			
6		1	4	12	6	11		5	18	11	2	9	K	D	E	L	E	G	A	T	E	T	L		
17	18		5	4	12	6	1	4	14	2	3		M	I	T	O	M	A	N	E	T	D	E		
2		1	7	3	2	9	7	9	2	3			K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	N		
	14	4	1	7	9	4	3	7	9	2	3		O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	F	T	
18	4		6	9	8		4	12		7	9		M	N	I	E	N	O	G	A					
	9	2	12	2	4		12	3		9	2	18	P	S	N	N	I	M	A	L	L	I			
4	8		2	3		8	6	6		6	16	15	A	M	I	A	N	T	K	O	S	E			
5	K	4	12	3		11	2	5			3	6	12	N	O	T	E	K	I	P	O	R	E		
15	3	6		1	2	3	4		3	2	11	2	I	T	N	E	T	I	L	E	N	I	E		
17		9	9	15	16	4			4	9	3	2	3	A	L	I	B	I	S	I	R	T	A	R	I

- "Kërko shumë nga vetja jote,
- dhe pritni pak nga të tjerët.
- Do të shpërtoni nga shumë vështirësi."
- Eshhtë më e lehtë të jesh i mençur për të tjerët sesa për veten tënde.

- Atë që nuk mund ta shprehni qartë, nuk e dini,
- me mendimin lind fjala në buzë e njeriut,
- shprehja e paqartë është ajo që vjen nga mendimi i paqartë.
- Gjithmonë kur diçka vjen papritur në jetën tuaj, ikën në të njëjtën mënyrë !!!

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR

F	A	U	T	O	P	O	R	T	R	E	T	
A	S	T	R	I	D	C	K	O	R	E	E	K
A	R	E	M	A	R	A	C	B	E	P	M	A
A	K	M	A	R	A	T	O	N	A	A	P	
D	O	N	A	T	O	R	E	T	R	I	T	A
P	I	R	A	T	I	I	E	T	C			
K	I	N	E	M	A	T	E	F	E	R	R	I
K	I	T	A	A	M	E	T	R	A	T	E	
I	V	E	N	U	S	B	E	V	E			
J	O	E	R	E	R	P	E	T	A	L	E	T
I	D	A	T	I	K	A	E	M	I	L	E	
M	A	T	A	M	I	N	A	R	E	T	T	
P	T	E	R	V	M	A	R	A	T	B		
E	R	A	M	E	Z	O	N	E	T	M	A	
R	E	M	T	R	E	L	O	M	R			
T	N	A	K	O	L	O	N	I	T	E	I	
P	E	R	S	E	R	T	E	S	T	E	T	
A	T	E	L	E	G	O	N	I	O	P	O	
T	R	E	N	T	I	V	A	N	E	N		
E	M	R	A	T	Z	K	O	M	E	T	E	
T	I	T	M	A	N	E	T	M	A	T		
K	I	A	O	R	N	A	T	E	I	L		
K	D	R	O	M	A	N	E	R	A	E	K	
E	U	R	E	K	A	A	T	O	M	T	U	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

